



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e LVII-të (pesëdhjeteshtatë)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 29 shtator 2025.

Mbledhja filloi në orën 10;25 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Donjetë Baliu, ndërsa munguan Sebastina Vokri; Lirika Maliqi.

Nga LDK, Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; Fatmir Gashi; kurse munguan; Ilir Koprani; Qëndresë Haliti.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu, Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Avni Islami.

Të pavarur, Demokrat Hodolli, Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; znj.Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Liridon Gashi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Vlora Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE; Shuaib Blakçori-Drejtorja e Inspeksionit DI.)

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues të KFOR – LMT; media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë, theksoi, para se të fillojmë me mbledhjen dua që në emrin tim personal dhe në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit të them disa fjalë, sot jemi në mbledhjen fundit me gjasë, të mandatit të shtatë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandat i cili siç jemi në dijeni që nga mbledhja e parë ka filluar me sfida sepse ishte Pandemi ku kushtet ishin të jashtëzakonshme, me maska dhe ashtu kemi vazhduar, mirëpo fatmirësisht edhe ajo Pandemi kaloi dhe punët vazhduan dhe besoj me shumë suksese edhe pse në Kuvend shumë herë kemi pasë dallime politike mirëpo qëllimet gjithherë kanë qenë të mira dhe konsideroj se asnjëherë anëtarët e Kuvendit nuk kanë pasë ndonjë qëllim të keq edhe pse janë dhënë mendime të ndryshme sepse shumë herë për të arritur diku dhe diçka ka rrugë të ndryshme andaj secili prej tyre e ka menduar rrugën e vet që është rruga më e mirë, më e shkurtër dhe ndoshta më e drejtë, mirëpo çdo herë përfundimet janë bërë dhe çështje janë vendosur me shumicë të votave e që është parim në demokraci ku shumica vendosë.

unë kam kaluar mirë dhe kam fjalë falënderuese për të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës nga të gjitha partitë politike. Po ashtu bashkëpunimi ka qenë i mirë edhe me drejtorët/shat e Drejtorive ku shumica prej tyre kanë qenë aktiv edhe pse ka pasë disa raste ku disa drejtorë kanë përfunduar mandatet më herët dhe pastaj deri janë ardhur të rinjtë dhe derisa janë adaptuar në qeverisjen komunale mirëpo bashkëpunimi ka qenë i mirë ashtu siç ka qenë edhe me stafin e Komunës sidomos me Zyrën Ligjor, me stafin e IT që na ka përcjellë gjatë këtij mandati kështu që mund të them se kemi përfunduar një mandat me sukses dhe tani kemi zgjedhjet për çka shfrytëzoj rastin t'iu uroj suksese të gjithë atyre që zgjidhen edhe për një mandat por edhe atyre që nuk zgjedhën ju uroj suksese në jetë dhe në rrugëtimin e tyre që e kanë zgjedhë.

Pra edhe njëherë ju falënderoj gjithsecilin për punën dhe angazhimin që e keni bërë gjatë këtyre 4 viteve, ju faleminderit.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, po shfrytëzoj nga rasti edhe unë duke pasë parasysh që për një pjesë të asambleistëve ndoshta mund të jetë takimi i fundit të kësaj legjislature. I falënderoj të gjithë për bashkëpunimin dhe gjithë atyre që janë proces zgjedhor ju dëshiroj të kenë suksese dhe të vazhdohet që t'i realizojnë objektivat të cilat i'a kemi vu vetit përpara.

Unë jam i kënaqur që për këto katër vite për punën e përbashkët këtu në këtë Kuvend, kemi arritur që shumë punë dhe projekte të mira të qojmë përpara pavarësisht dallimeve politike që në momente të caktuar kanë ekzistuar dhe mirë është që ekzistojnë sepse jemi në demokraci dhe që sigurisht që edhe pushteti pa e pasë një opozitë të mirëfilltë mund të bëjë dhe lëshoj gabime gjatë procesit të punës, andaj unë i vlerësoj të gjitha ato që kanë qenë qëllim mira, në interes të përgjithshëm dhe shpresoj që me ata që do të kenë fatin të zgjedhën, të vazhdojmë me punë të mira dhe projekte të mira për Podujevën dhe Llapin në përgjithësi. Ju faleminderit shumë.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, faleminderit i nderuar Kryetar, tani vazhdojmë me punë dhe para se të fillojmë në vazhdim kemi:

Dhënia e Betimit nga anëtari i Kuvendit të Komunës së Podujevës z.Avni Islami, (i emëruar me Vendimin e KQZ nr.01/2319-2025 datë 03.09.2025)

Siç jeni në dijeni ish anëtari i Kuvendit të Komunës së Podujevës nga radhët e Organizata Balli Kombëtar Demokratik Gazmend Islami pas një sëmundje të rëndë ka ndërruar jetë. Si Kryesues i Kuvendit të Komunës kam marrë të gjitha veprimet e nevojshme për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit dhe janë zhvilluar procedurat për zëvendësimin e të përmendurit, e që më datë 03 shtator 2025 KQZ ka marrë Vendim nr.01/2319-2025 sipas të cilit zotëri Avni Islami është emëruar anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës duke zëvendësuar ish anëtarin e lartpërmendur.

Me këtë rast z.Avni Islami është kontaktuar dhe njoftuar lidhur me këtë i cili tani edhe është prezent, andaj kërkohet që të jap betimin solemn para Kuvendit të Komunës, mirëpo kërkohet nga Komisioni për verifikimin e mandateve që paraprakisht të bëjë verifikimin e mandatit.

Ju e dini që anëtarët e Komisionit janë znj.Donjetë Sheqiri, znj.Sebastina Vokri dhe znj.Endritë Murati, dy prej tyre janë prezent tani prandaj urdhëroni mund ta bëni verifikimin e mandatit të zotëri Avni Islami dhe pastaj të paraqisni raport të shkurtër rreth këtij procesi.

(Nga Komisioni në fjalë bëhet verifikimi i mandatit të z.Avni Islami dhe njëkohësisht jepet raporti përkatës)

znj.Donjetë Sheqiri, në emër të Komisionit për verifikimin e mandateve, e paraqiti raportin, theksoi, fillimisht më lejoni të shprehë keqardhjen time personale që dy javë para përfundimit të mandatit të këtij Kuvendi po bëhet zëvendësimi i anëtarit të Kuvendit të Komunës nga z.Avni Islami për shkak të vdekjes së ish anëtarit kolegut tonë Gazmend Islami, andaj më lejoni të shprehe ngushëllimet e mia në emër të Grupit të LDK-së dhe në emrin tim personal.

Në emër të komisionit për verifikimin e mandateve konsiderojmë dhe konstatojmë që të gjitha procedurat janë në rregull dhe mund të vazhdohet me dhënien e Betimit nga anëtari i Kuvendi të Komunës z.Avni Islami, të cilit njëkohësisht i dëshirojmë suksese.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, pra pas verifikimit të mandatit nga ana e Komisionit përkatës, konsideroj se tani gjithçka është në rregull, andaj ftoj z.Avni Islamin të ngritën në këmbë dhe të jap betimin solemn, unë e lexoj pjesë pjesë tekstin e betimit, kurse ti e përsërit me zë atë, me të vetmin ndryshim që në fillim të tekstit ti e cek emrin dhe mbiemrin tuaj. Pra mund të fillojmë.

Me tekstin si në vijim jepet Betimi nga anëtari i Kuvendit të Komunës së Podujevës z.Avni Islami.

“Unë, Avni Islami, betohem se do t’i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltarë i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, urime, tani mund ta nënshkruash deklaratën e betimit dhe me këtë akt nga ky moment je anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e barabarta me të gjithë. Ndërsa ne tani vazhdojmë me punë sipas rendit të ditës.

Rendi i Ditës

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, edhe njëherë konstatojmë se prezent në sallë për momentin janë 29 anëtarë/e të Kuvendit dhe mund të vazhdojmë, por para se të fillojmë me rendin e ditës urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, më lejoni që lidhur me rendin e ditës të propozoj edhe 2 pika që të inkuadrohen si pika shtesë në këtë rend të ditës në këtë mbledhje, ato janë:

1-Propozim vendimi që NPL “Eko-Llapi” t’i ndahet një subvencion në shumë 30,000.00€, subvencion i cili ka për qëllim rritjen e kapitalit punues të Ndërmarrjes, do të thotë për makineri dhe çështje tjera si dhe me qëllim që kjo Ndërmarrje t’i kryej edhe disa shërbime shtesë në të mirë të shërbimeve publike të Komunës së Podujevës siç është pastrimi i lumenjve dhe çështje tjera të cilat me makinerinë ekzistuese nuk ka mundësi t’i kryej.

2-Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin Furnizim me pajisje për blegtori, për çka siç jemi të informuar që për projekte të tilla vazhdimisht po kalojnë si pika përmes Kuvendit të Komunës, pra bëhet fjalë për një Kontratë që është “Furnizim me Pajisje për Blegtori” në vlerë 41, 990.00€ ku 30% të kësaj Kontrate dihet që në Bazë të rregullores për ndarjen e subvencioneve, është participim i fermerëve dhe shuma prej 12,597.00€ duhet të merret prej fermerëve që t’i shtohet vlerës së projektit në mënyrë që të mund të ekzekutohet si projekt.

(Anëtarëve të Kuvendit i’u shpërndahet materiali përkatës i këtyre dy propozimeve të paraqitura nga drejtori parafolës, për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pika shtesë)

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani i hedh në votim veç e veç këto dy propozim vendime të paraqitura nga drejtori i DBF paraprkisht, që të hyjnë si pika shtesë në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje dhe atë sipas radhës përkatëse.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 31 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 20 vota Për, 8 vota Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje si pikë shtesë:

- Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale-“Eko-Llapi” Sh.A, (sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë)

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 31 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 20 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje si pikë shtesë:

- Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “Furnizim me Pajisje për Blegtori”, (sipas materialit përkatës të prezantuar).

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës, përfshirë Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së si edhe 2 pikat shtesë të mbështetura paraprkisht, sipas propozimeve përkatëse të prezantuara në fillim të mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 31 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 20 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së, si dhe 2 pikat shtesë të mbështetura paraprkisht, sipas propozimeve përkatëse të prezantuara në fillim të mbledhjes.

Rendi i miratuar i ditës:

- 1.Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 30 korrik 2025.
- 2.Propozim Vendimi për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore 2027-2028
- 3.Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare ndërmarrjes publike lokale-“Eko-Llapi” Sh.A,
- 4.Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “Furnizim me Pajisje për Blegtori”,
- 5.Të ndryshme

1. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 30 korrik 2025.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali.

z.Naim Çunaku, theksoi, përshëndetje për të gjithë, të nderuar këshilltare dhe këshilltarë të këtij Kuvendi të kësaj legjislature gjegjësisht këtij mandati që u përfol nga Kryesuesi i Kuvendit dhe nga Kryetari i Komunës në fillim të mbledhjes duke i kualifikuar si seanca e fundit e këtij mandati e që mua më duket që në rend të parë është një konstatim jo i drejtë sepse e dim që mandati jonë dhe i kësaj legjislature përfundon në atë moment kur anëtarët e rijnë e japin betimin, pra deri atëherë jemi në detyrën e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës dhe uroj që Komuna jonë të mos ketë nevojë për mbledhje të Kuvendit deri në konstituimin e mandatit të ri të Kuvendit të Komunës, e që nga praktikat e konstituimit të Kuvendit po besoj se neve nuk do të na sjellë një gjendje ku do të thirret mbledhje dhe të merren vendime nga kjo legjislaturë qysh është tani, pra uroj të jetë ashtu që deri në përbërjen e re të mandatit të atyre që marrin të mos ketë nevojë të

mbajtjes së ndonjë mbledhje sepse në kuptimin e afatit kohorë jemi në detyrë dhe ka kohë edhe për mbledhje të rregullta por edhe në rast të paraqitjes së nevojave edhe për mbledhje të jashtëzakonshme. Ndoshta paksa dola jashtë rendit të ditës dhe e shfrytëzoja këtë sepse nuk ishte në rend të ditës që të deklarohemi rreth mandatit tonë.

Tani po kthehem në temë, përkatësisht tek Procesverbali nga mbledhja e datës 30.07.2025, pas lëshimit të seancës nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së, zotëri Kryesues i Kuvendit në mungesë të kuorumit i'a ke dhënë të drejtën e fjalës një anëtar i Kuvendit që të merre fjalën dhe të bëjë konstatime të cilat nuk janë në këtë Procesverbal.

Për t'u bërë më i kjashtë, kolegu u nderuar e përmend emrin tim duke thënë se Naim Çunaku e tha se nuk ka Vetëvendosje, por unë e kam konsultuar dhe të gjithë tjerët e kemi Procesverbalin e asaj mbledhje se çfarë kam thënë, dhe askund unë Naim Çunaku nuk kam konstatuar që nuk ka Vetëvendosje, përjashtoj atë qysh e kam thënë edhe njëherë më parë që nëse kemi aso aftësi telepatike ta dimë edhe leximin e mendjes e që nëse ka qenë lexim i mendjes që të mbetet në vullnetin tim a do të duhej të kishte apo jo, unë në ato kualifikime nuk hy sepse fundja qytetarët janë ata që mundësojnë një subjekti politik ta ketë at fuqi, dhe në asnjë mënyrë nuk e kam përmendur atë fjalë.

Çështja tjetër i nderuar Kryesues i Kuvendit, një konstatim i tillë jo kolegial të shprehur nga kolegu, dhe të bëhet konstatim se kush do të shkoj në pension vërtetë është jashtë njerëzores, fundja nëse dëshironi po e lexoj pjesën nga procesverbali sakt qysh është thënë, (*"diçka interesante është kur zotëri Çunaku e tha në fjalimin e tij se nuk ka Vetëvendosje, e unë zotëri Çunakut i them se me 12 tetor 2025 do ta merre përgjigjen dhe gjithashtu në këtë datë do të pensionohen shumë politikan të së kaluarës"*) së pari duhet sqaruar kush është politikan i së kaluarës, nëse në vitet 1989 e këndej janë politikan të së kaluarës, për mua nuk janë të politikës së kaluar për shkak se si rezultat i asaj politike jemi në këtë ditë këtu, dhe t'ju dëshirosh në formë cinike njerëzve që nuk e di a din kolegu im i nderuar që në politikë nuk ka datë të pensionimit, pensionimin në politikë e bënë vota e qytetarëve, e vota e qytetarëve do të jetë më 12 tetor 2025 e kush dhe çfarë do të thotë qytetari ne do të jemi këtu dhe me verdiktin e qytetarit ne gjithmonë e kemi respektuar dhe do ta respektojmë. Prandaj kesh i obliguar të reagoj sepse u ndjeva i fyer nga ajo kur dikujt i thuhet diçka që nuk ka thënë, unë nuk po dua t'i uroj ndokujt të jetë mbledhja e fundit, por ta kapërcejmë ashtu qysh do të duhej në formë kolegjale, por vërtetë ishte vërejtje që nuk mund të kapërcehej pa u potencuar.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth këtij Procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim sipas materialit përkatës.

Pas votimit, u konstatua se Njëzëri me 30 vota Për nga anëtarët e Kuvendit sa shin prezent, miratohet Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 30 korrik 2025, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe konstatimin e deklaruar nga parafolësi z.Naim Çunaku.

2. Propozim Vendimi për miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore 2027-2028

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, më lejoni që para juve të prezantoj projektbuxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe projeksione buxhetore për vitet 2027-2028, projektbuxhet i cili është në kompetencë të Ekzekutivit të Komunës t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës dhe pastaj Kuvendi ta shqyrtoj dhe miratoj këtë dokument i cili padyshim është një prej dokumenteve që e voton ky Kuvend Komunal ku komplet paraqiten investimet që do të realizohen gjatë vitit 2026 apo edhe projeksione të cilat janë të planifikuara në dy vitet vijuese.

Buxheti total i Komunës së Podujevës për vitin 2026 në bazë të Qarkores Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave është 34,778,954.00 €, dhe ky buxhet është bashkim i grantit të përgjithshëm që përbëhet prej grantit specifik të arsimit, ai i shëndetësisë si dhe të hyrave vetanake, të cilat granti i përgjithshëm së bashku me financimin e Teatrit që janë përcaktuar në Qarkoren Buxhetore në shumë 17,812.000.00€, shëndetësia primare 3,687,491.00€, dhe granti i arsimit i cili është 13,690,040.00€, si dhe të hyrat vetanake si total që janë të planifikuara 2,356.000.00€.

Pra ky buxhet është i planifikuar dhe normuar në bazë të Qarkores Buxhetore ku përfshihen të gjitha kategoritë e buxhetit siç është buxheti për paga që është në shumë 19,925.293.00€, buxheti i mallrave dhe shërbimeve 3,592,049.00€, buxheti për shpenzime komunale 694,612.00€, buxheti për subvencione dhe transfere 1,810,000.00€, dhe buxheti për shpenzime kapitale 8,757,000.00€.

Ky buxhet është i shpërndarë në të gjitha programet të cilat menaxhohen dhe që janë kompetencë e Komunës duke përfshirë administratën, zhvillimin ekonomik, bujqësinë, planifikimin urban, infrastrukturën publike, zjarrfikësit, kulturën, teatrin, arsimin, shëndetësinë, dhe të gjitha këto janë të përcaktuara në tabelat që i keni në dokumentacion ku janë të planifikuara në të gjitha programe mjete buxhetore të cilat janë për paga, mallra, komunali, subvencione, dhe për kapitale.

Edhe në këtë buxhet për vitin 2026 ashtu sikurse në vazhden e buxheteve tjera janë të planifikuara shumë projekte të cilat janë zhvillimore për Komunën e Podujevës si në fushën e arsimit, ekonomisë, bujqësisë, infrastrukturës e të tjera.

Për vitin 2026 janë rreth 2,302,000.00€ që do të investohen në infrastrukturë rrugore, pastaj kemi investime shumë të rëndësishëm që janë në fushën infrastrukturës publike në kuadër të shërbimeve publike siç është një ndër ato ndërtimi i kolektorit që është vazhdimësi e ndërtimit, mandej ndërtimi i kanalizimeve, trotuareve, pastaj kemi financime që janë në fushën e shëndetësisë e që dihet se ky sektor në kategorinë e mallrave është i mbuluar jashtëzakonisht mirë në këto vite dhe vazhdojmë me buxhet të mjaftueshëm në kategorinë mallrave që mbulohen edhe shpenzimet për barna, reagenca, shpenzime tjera të cilat shpenzohen për pjesën e logjistikës në mënyrë që sektori i shëndetësisë të ketë një funksionim normal.

E njëjta gjë është edhe për çështjen e arsimit ku kemi buxhet të rritur në krahasim me buxhetet paraprake qoftë në kategorinë e pagave qoftë tek investimet kapitale, ku në qoftë se marrim vitin 2026 pa përfshirë projeksionet buxhetore për vitet 2027 dhe 2028 kemi të planifikuar ndërtimin e anekseve të shkollave “Dr.Ibrahim Rugova”, “Enver Maloku”, “Xheladin Rekalu”, pastaj ndërtimin e institucioneve tjera arsimore siç janë shkollat “Nuhi Gashi” në fshatin Bradash, Jetullah Gashi” në Dobërdol.

Mandej në fushën e ekonomisë është planifikuar infrastrukturë e turizmit, Zona Industriale e cila është edhe në këtë buxhet e që shpresoj se shpejt të filloj ndërtimi ku buxheti kryesor është i Ministrisë së Industrisë por edhe ne kemi pjesën tonë të buxhetit të planifikuar në vitin 2026.

Po ashtu edhe në fushën e kulturës kemi buxhet për investime siç janë ndërtimi i terreneve sportive, renovimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, e të tjera.

Në fushën e bujqësisë, përveç subvencioneve që janë në vlerë rreth 700,000.00€ kemi edhe përqindjen e buxhetit për subvencione për blegtori, bletari, perimtari, e të tjera, kemi edhe për investime kapitale siç është ndërtimi i parkut industrial bujqësorë në fshatin Sfeçël ku sivjet besoj se do të filloj ndërtimi i tij projekt i cili është dy vjeçar prandaj kemi planifikuar buxhet edhe për vitin 2026, dhe gjithashtu kemi edhe projektin për ndërtimin e sistemit të tokave bujqësore që është për vitin 2026 por edhe në projeksionet e viteve 2027-2028 ku do të jetë një kod i përhershëm buxhetor duke pasë parasysh rëndësinë e ndërtimit të sistemit të ujitjes të tokave bujqësore.

Nuk dëshiroj t'ju marrë kohë më shumë në këtë fjalë hyrëse, por kam vetëm edhe disa përmirësime teknike të cilat do t'i paraqes në vazhdim, dhe do të kërkoj që ky buxhet të miratohet me këto përmirësime teknike në raport me udhëzimet dhe rregulloret administrative të Ministrisë së Financave, ato janë si në vijim:

Në vitin 2027 granti për shëndetësi, shtohet buxheti në kategorinë e mallrave për 73,412.00€ dhe i njëjti zvogëlohet në infrastrukturë publike për mallra dhe shërbime.

Në vitin 2028 granti për shëndetësi rritet në vlerë 144,359.00€ ndërsa zvogëlohet në infrastrukturë publike në kategorinë mallra dhe shërbime që do të thotë se në shëndetësi rritet në mallra dhe shërbime.

Në vitin 2028 granti për Teatrin rritet për 10,467.00€ kurse ndryshimi bëhet në bujqësi në kategorinë e subvencioneve

Gjithashtu janë edhe disa emërtime të projekteve siç është asfaltimi i rrugëve në qytet ku e keni në dokumentacionin që ju është përcjellë, e që zëvendësohet me asfaltimin e rrugëve në qytet nga rr."Zahir Pajaziti" deri te rr. Skënderbeu";

Rregullimi i hapësirave publike, zëvendësohet me rregullimin e hapësirave publike përgjatë brigjeve të lumit Llap;

Rregullimi i lumit Llap, përmirësohet duke u shkruar zgjerimi dhe rregullimi i lumit Llap nga qyteti deri në Lluzhan dhe nga qyteti deri në Kërpimeh;

Shenjëzimet horizontale dhe vertikale, zëvendësohen me shenjëzimet horizontale dhe vertikale nga rr."Zahir Pajaziti" deri te rr."Xhemajl Mustafa" dhe rr."Skënderbeu";

Ndërtimi i ndriçimit publik, zëvendësohet me ndërtimi i ndriçimit publik në qytet dhe fshatrat Batllavë, Orllan, Kërpimeh, Gllamnik, Shajkoc, Bradash e të tjerë;

Ndërtimi i trotuareve, zëvendësohet me ndërtimi i trotuareve në qytet dhe në fshatrat Kërpimeh, Orllan, Lluzhan, Gllamnik, Shajkoc, Siboc e të tjerë;

Rregullim i rrugëve me zhavorr, është ndërtimi i rrugëve nga fshati Bajçinë-Murgull dhe nga fshati Shajkoc-Orllan;

Ndërtimi i urave dhe kalesave, riemërtohet me ndërtimi i kalesave dhe urave të vogla në Llapashticë, Sfeçël, Bajçinë, Soboc, Gllamnik;

Ndërtimi i rrugëve me kubza, zëvendësohet me ndërtimi i rrugëve me kubza nga qyteti në Kërpimeh dhe nga Sekiraça deri në Lluzhan;

Rindërtimi i rrugëve, riemërtohet me rindërtimi i rrugëve të asfaltuara nga rr."Zahir Pajaziti" te rr."Skënderbeu" dhe rr."Xhemajl Mustafa";

Ndërtimi i terreneve sportive, ndryshohet me ndërtimi i terreneve sportive në qytet, Orllan, Dumnicë, Metehi, Shajkoc;

Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, zëvendësohet me renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore që objekti i shkollës së vjetër në Orllan;

Ndërtimi i sistemit të ujitjes së tokave bujqësore, zëvendësohet me ndërtimi i sistemit të ujitjes së tokave bujqësore nga Pollata deri në Lluzhan;

Blerja e pajisjeve mjekësore, bëhet fjalë për blerjen e rëntgenit dhe EKG për QKMF;

Renovimi i objekteve shëndetësore, zëvendësohet me renovimi i objekteve shëndetësore në QKMF-në kryesore;

Renovimi i institucioneve arsimore, bëhet fjalë për renovimi i shkollave në qytet “Naim Frashëri” dhe “Xheladin Rekalu”, si dhe shkollat në fshatrat Orllan, Luzhan, Dumnicë dhe Sfeçël;

Ndërtimi i tregut të kafshëve, bëhet fjalë për ndërtimin e tregut të kafshëve në periferi të qytetit;

Ndërtimi i parkut teknologjik, bëhet fjalë për ndërtimin e parkut teknologjik në Zonën Industriale.

Pra këto që i ceka janë për fillim si rezyme fillestare e prezantimit të këtij projektbuxheti për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028 dhe nuk dua të zgjati më shumë duke pasë parasysh se është dokument shumë i rëndësishëm i cili përcakton edhe rrjedhën e investimeve gjatë vitit 2026, andaj kërkojmë që të merr mbështetjen e juaj që edhe ju falënderoj për vëmendje.

z.Haki Rudari, theksoi, buxheti është një prej dokumenteve më me rëndësi të një Komune përmes të cilës parashihen investime në sektorë të ndryshëm dhe përmes miratimit të buxhetit unë konsideroj se duhet të arrihen këto objektiva apo qëllime të ndryshme siç janë përmirësimi i infrastrukturës në qytet, përmirësimi i infrastrukturës në fshatra, pastaj krijimi i një qyteti më të zhvilluar, ngritja e nivelit në arsim përmes investimeve të ndryshme, zhvillimi i shëndetësisë po ashtu përmes ofrimit të shërbimeve më cilësore, ngritja e mirëqenies sociale duke u mbështetur në zhvillimin ekonomik dhe përmes subvencioneve të ndryshme, zhvillimi i kulturës, rinis dhe sportit, pastaj zhvillimi i turizmit, bujqësisë dhe shumë të tjera.

Kur e them këtë bazohem edhe tek buxheti i cili besoj se do të miratohet në këtë mbledhje në shumë prej 34,778,954.00 € e që nga kjo shumë e përgjithshme dhe që mund t'i vërejmë në materialin e dërguar shohim se janë ndarë apo që shpenzimet do të jenë për paga, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, dhe unë tani dua të ndalem tek shpenzimet kapitale ku në vitin 2026 për investime të tilla kemi shumën prej 8,757,000.00€ e që natyrisht se me këtë shumë buxhetore nuk do të thotë se mbulohen të gjitha kërkesat por besoj se është një buxhet që përmes tyre do të ketë investime në Komunën e Podujevës qoftë në fshatra qoftë edhe nëpër lagje të qytetit, duke mos anashkaluar çdo herë edhe investime të arrijnë nga niveli qendrorë, prandaj në emër të Grupit të LVV-së ne do t'i japim përkrahje këtij buxheti dhe konsiderojmë se investimet e ndryshme janë investime që sa do pak do të ngrisin mirëqenien e qytetarëve por në të njëjtën kohë po ashtu do të hapin edhe vende të reja të punës përmes investimeve në sektorë të ndryshëm.

z.Valon Demolli, theksoi, sot kemi propozim vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës dhe në këtë aspekt unë nuk e di se shefi Grupit të LVV-së dhe unë a jemi duke folë për të njëjtën Komunë, mirëpo sa e di unë jemi në Komunën e Podujevës.

Kështu që buxheti komunal përbën dokumentin më të rëndësishëm për qytetarët tanë pasi që aty përcaktohet mënyra se si shpenzohen mjetet publike, megjithatë buxheti paraqitur nga Ekzekutivi i Komunës nuk reflekton në interesin e qytetarëve por është por është i ndërtuar mbi interesat e ngushta partiake.

Në vend që të adresohen prioritet reale në arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë, ky buxhet është orientuar drejtë shpërblimeve politike dhe orientimeve të lidhura me militantizëm, andaj për këtë arsye ne Grupi i LDK-së nuk mund ta mbështesim një projekt buxhet i cili nuk garanton garanci dhe transparencë në shpërndarjen e mjeteve publike.

Qëllimi është i qartë, nuk bëhemi pjesë e miratimit të një buxheti i cili përjashton qytetarët dhe që shndërrohet në instrument politikë. Ne kërkojmë një buxhet transparent, gjithëpërfshirës dhe të ndërtuar mbi parimin e interesit publik ku prioritet do të jetë qytetari e jo interesi partiak.

Kryetari Komunës po e shfrytëzon buxhetin si bankomat partiak, e ne nuk bëhemi garant për këtë skandal, nëse buxheti ndahet me librezë partie qytetarët le të presin në radhë, por vota jonë nuk është aty.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sot po diskutojmë për buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2026, siç e dini afati ligjor për miratimin e buxhetit është fundi i shtatorit.

Buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2026 është 34,778,954.00€. Mos miratimi i buxhetit d të sjellë pengesë për të gjithë zyrtarët që pagat i marrin nga buxheti komunal si dhe do të pengonte fillimin e procedurave për realizimin e shumë projekteve dhe do ta rriste mundësinë që Komunës së Podujevës që në vitin 2026 t'i mbetet më shumë suficid, kështu që kushdo që do të qeverisë me Komunën e Podujevës që i jepet nga verdikti i dalë nga zgjedhje lokale të 12 tetorit 2025 do të mund të realizoj objektivat dhe prioritet që ka përmes këtij buxheti.

Të gjithë e dimë se në vitin 2026, në muajin mars mund të bëhet riallokimi i të hyrave vetanake nga viti 2025, si dhe me vendime të ndryshme nga Kuvendi i Komunës mund të riallokohen mjete ku edhe mund të ndryshohen projektet.

Për fund, meqë kjo është seanca ime e fundit në këtë Kuvend sepse nuk jam pjesë e garës zgjedhore, dua t'ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin si dhe ju dëshiroj suksese të gjithë juve që jeni në garë. Ju faleminderit shumë.

z.Adnan Zymeri, theksoi, sot po diskutojmë për projektbuxhetin e Komunës tonë për vitin 2026, dokument ky i cili sikurse gjithmonë paraqet diskutimin më të rëndësishëm vjetor të cilin secili nga ne e në këtë rast do të thotë ky është dokumenti më i rëndësishëm duke marrë parasysh faktin që jemi në një proces elektorale dhe ngarkesat, rrjedhimisht edhe fjalët më të arsyeshme për njërën palë mund të duken shumë të paarsyeshme për palën tjetër, por mbi të gjitha mund të theksoj se planifikimi i mirë financiarë është çelësi i zhvillimit të Komunës ndërsa një planifikim i dobët sjellë pasoja të drejtpërdrejta për qytetarët.

Ky projektbuxhet paraqet një tërësi projektesh të fushave të ndryshme duke filluar nga furnizimet me barna në shëndetësi, ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturë, shkollave në arsim e deri tek mbështetja e rinisë dhe iniciativave bujqësore, por ë këndvështrimin tim nuk paraqet qasje zhvillimore përtej një administrimi të zakonshëm që bëhet nga viti në vit.

Secili buxhet njëjtë sikurse ky për të cilin po flasim sot duhet të jetë refleksion i nevojave reale të qytetarëve, e nevojat reale paraqiten me pjesëmarrjen qytetare rreth diskutimeve mbi buxhetin, pjesëmarrje e cila sillet në secilin vit ishte koti edhe në këtë vit, prandaj sa është ky buxhet reflektim i nevojave të qytetarëve mbetet në procesin që po na pret.

Element tjetër tashmë i zakonshëm është edhe orientimi i mjeteve në projekte të paqarta dhe të përgjithësuara që do të shkaktoj konfuzitet dhe probleme tash më të njohura mes banorëve gjatë procesit të implementimit të projekteve, por për të shmangur këto probleme është thelbësore që buxheti të bazohet në analiza reale, të jetë i harmonizuar me Planet Zhvillimore të Komunës, të hartohet me pjesëmarrje aktive të qytetarëve por mbi të gjitha dhe pavarësisht të gjithave asnjë buxhet nuk do t'i pasqyroj në tërësi nevojat specifike dhe urgjencat eventuale që mund të dalin gjatë vitit të implementimit, në këtë rast në vitin 2026, prandaj nga përvoja ime tashmë 8 vjeçare në 2 mandate kam kuptuar që më e rëndësishme se bllokada është pjesëmarrja, përkundër që ka subjekte politike që e kanë në gjake bllokadës, unë kam vendosur që të marrë pjesë duke votuar Pro këtij projektbuxheti, dhe meqë është fjala ime e fundit në këtë Kuvend si anëtar i Kuvendit dua të kujtohem si dikush që nuk bllokoi por që kontribuoi.

Faleminderit nga zemra të gjitha atyre që më besuan këto 8 vite, ju kërkoj fale të gjitha atyre që më besuan dhe ndoshta nuk janë ndier të përfaqësuar. Secilit nga kolegët me ët cilët kam debatuar dhe që kanë mund të ndihen të lënduar ju them që ky nuk ka qenë qëllimi im, dhe secilit nga kolegët që tani është në garë dhe të tjerëve që janë jashtë këtij Kuvendi i'u uroj suksese dhe mbarësi pa fund në këtë garë, Zoti e bekoftë Podujevën, Zoti e bekoftë Kosovën, ju faleminderit shumë.

z.Arjant Topanica, theksoi, nën supozimin se kjo do të jetë mbledhja e fundit e këtij Kuvendi të kësaj legjislature po shfrytëzoj nga rasti që të mos i'u mbetem borgj por t'i falënderoj të gjithë qytetarët e Podujevës për pjesëmarrjen e tyre në qytetarinë aktive, për të gjitha kritikën, sugjerimet dhe kërkesat e drejtuara në adresë tonën që përmes tyre të jemi më përfaqësues të tyre denjësisht në këtë Kuvend dhe kështu qëllimin tonë që për të qenë këtu dhe për t'i përfaqësues interesat, kërkesat, nevojat, shqetësimet e tyre t'i qojmë deri në fund dhe t'iu dalim zot atyre për çka na kanë zgjedhë ata, andaj edhe njëherë faleminderit të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës që na kanë ndjekur dhe përcjellë duke qenë aktivisht pjesëmarrës në vendimmarrje në Podujevë.

Sa i përket pikës së rendit të ditës që është projektbuxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028 unë do të fokusohem kryesisht në Drejtorisë apo në buxhetet e Drejtorive përkatëse fillimisht duke thënë se si dokument dhe si buxhet në tërësi nëse marrim dhe e shikojmë duket të jetë një buxhet, një dokument nëse mund të shprehem kështu "tallava", i ndërtuar duke u bazuar në dokumentet tjera paraprake dhe me shifra të cilat vetëm figurojnë sa për t'i përmbushur rubrikat e këtij dokumenti, një buxhet i cili nuk e ka në fokus qytetarin duke specifikuar saktësisht se çfarë do t'i kontribuohet atij mirëpo vetëm sa për t'i precizuar shifrat, për t'i përmbushur shifrat në mënyrë që të shfrytëzohet sipas dëshirave klienteliste të tyre.

Kur jemi te Drejtoria e Infrastrukturës vërejmë se kemi një varg shërbimesh kontraktuale mbi 190,000.00€ për çka dua të pyes çka janë këto shërbime kontraktuale në këtë shumë në këtë Drejtori që e ceka. Po ashtu te e njëjta Drejtori kemi subvencione në shumë 130,000.00€ për çka po ashtu pyes për çfarë janë këto subvencione në Drejtorinë e Infrastrukturës kur jemi në dijeni për shërbimet që i kryen kjo Drejtori.

Te Drejtoria e Urbanizimit, te shtrimi i rrugëve me asfalt shohim se kemi të gjitha fshatrat të përfshira me nga një shumë buxhetore nga 20,000.00€ deri në 30,000.00€, kjo tregon se ka jo seriozitet dhe jo profesionalizëm në këtë buxhet sepse nuk i kanë të gjitha fshatrat nevojat e njëjta për asfalt dhe nuk mund t'i kenë për tri vite me radhë. Sërish në tri vitet e ardhshme sa kam parë, dua ta ngris sërish si shqetësim që nuk ka të caktuar një kod buxhetor specifik për shtrimin e rrugës që njihet në popull si rruga e "Polonicave", për çka është hera e pastë që e kam ngritë këtë duke kërkuar të shtrohet ajo rrugë, madje kam fole edhe me drejtor të Drejtorive dhe po e shfrytëzoj edhe tani rastin kur po thuajse është mbledhja e fundit e kësaj legjislature të Kuvendit sepse kemi kërkesa të shumta nga ajo pjesë që të merret më seriozisht ajo rrugë, përndryshe nëse ka diçka që e pengon le të na tregojnë, mirëpo është hera e pestë që unë po ngris si shqetësim dhe sërish në tri vitet e ardhshme nuk ka të paraparë buxhet për atë rrugë, pra edhe njëherë e them se bëhet fjalë për rrugën nga Emergjencia e re në drejtim të fshatit Surkish dhe vazhdon deri në fshatin Sfeçël e që qytetarët e asaj pjese e njohin si rruga e "Polonicave" e cila ka mbete më pak se 2 km, dhe tash e sa vite nuk përmendet fare dhe as nuk merret parasysh.

Tek Drejtoria e Shëndetësisë kemi subvencionim të administratës me kod buxhetor në shumë 250,000.00€, andaj edhe për këtë dua ta di se çka do të subvencionohet administrata e Drejtorisë së Shëndetësisë me këtë vlerë kaq të madhe apo një çerek milioni euro.

Tek Drejtoria e Inspeksionit kemi për rrënimin dhe largimin e objekteve vlerën 45,000.00€, a nuk ka mund të specifikohet se çka do të rrënohet me këtë vlerë.

Tek Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, për Zonën Industriale kemi 150,000.00€ në vitin 2026, kurse për vitet 2027 dhe 2028 për Zonën Industriale nuk ka asnjë cent të planifikuar, atëherë meqë është një projekt që po mburreni me atë qysh për tri vite rresht me 150,000.00€ për një Zonë Industriale që përfaqëson dhe që është interes i të gjitha bizneseve Llapjane, vërtetë kjo është për keqardhje.

Te ky projekt për investime kapitale të orientuara kryesisht pa specifikime me qëllimin e vetëm të përdorimit klientelist të mjeteve buxhetore dhe si rezultat i kësaj edhe në Raportet e Auditimit tash

e sa herë gjetjet e tyre janë mos specifikim i buxheteve dhe tani sërish vazhdohet i njëjti avaz e që sërish presim që edhe Raporti i ardhshëm i auditimit të jetë Raport i kualifikuar.

Po ashtu tek investimet kapitale vërejmë se për vitin 2024 dhe për vitin 2025 kemi pothuajse të njëjtën vlerë për investime kapitale që është 8,756,700.00€, pyetja është përse nuk kemi rritje për investime kapitale në vitin 2025 kemi të njëjtën vlerë, kurse të parapara për vitet e ardhshme për shpenzime kapitale kemi mbi 10 milion euro.

Pra kjo ishte përafërsisht një përmbledhje e gjetjeve tona, pa dashur të hyjmë në detaje, mirëpo do të doja të marrë përgjigje për këto pyetje dhe këto shqetësime që i ngrita, dhe përfundimisht të them se të uroj ky do të jetë buxheti i fundit që miratohet nga kjo qeverisje dhe kjo parti, faleminderit qytetarëve.

z.Burim Hasani, theksoi, sot në këtë seancë në rend të ditës kemi shqyrtimin dhe miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 si dhe parashikime buxhetore për vitet 2027 dhe 2028. Gjatë këtij mandati e sidomos në këtë vit kam bërë dy kërkesa, njërën me shkrim, tjetrën publikisht këtu në Kuvend, në lidhje me një rrugë e cila lidh fshatin Bradash me fshatin Velikorekë, fjala është për rrugën “Rakitat”. Pra ne e dim që për vitin 2026 për të gjitha rrugët janë të paraparë buxhet kryesisht për asfaltimin e tyre në vlera rreth 300,000.00€ e që e dim se ky buxhet nuk mjafton ta marrim shembull për një fshat i cili ka një sipërfaqe të madhe dhe një numër të banorëve po ashtu në krahasim me fshatrat tjera. Pra është e rëndësishme që rruga “Rakitat” në fshatin Bradash e cila lidhet nga varrezat e fshatit Badash me fshatin Katunishtë-Lagja e Brymollëve, e që është rrugë lidhëse dhe rrugë ndihmëse në të cilën qarkullojnë edhe bujqit dhe në përgjithësi fshatarët si dhe është rrugë lidhëse me fshatin Obrançë dhe ka qasje të lehtë me pjesën që lidhet me magjistralen për në Prishtinë.

Po ashtu edhe një pikë tjetër në lidhje me një kërkesë është nga fakti se po shohë që në shumë fshatra në Komunën e Podujevës janë duke u ndërtuar Çerdhe dhe Anekse të ndryshme, pra edhe për këtë kam një kërkesë me shkrim dhe po ashtu edhe publike nga seanca e kaluar dhe këtë sot tani po bie ta cekë edhe njëherë pa dashur të merret në mënyrë politike, fjala është për fshatin Bradash ku gjatë një analize të bërë në këtë vit, në çerdhet publike dhe private nga fshati Bradash janë të regjistruar 46 fëmijë, dhe tani është e rëndësishme që në fshatin Bradash edhe pse sot e kemi pikë të rendit të ditës për ta votuar një shumë prej 300,000.00€ për shkollën “Nuhi Gashi” e cila do të ndërtohet në fshatin Bradash, është e rëndësishme që këtu të planifikohet ose të nxjerrët një aneks i veçantë ose një aneks brenda shkollës sepse 46 fëmijë të shkojnë të strehohen gjysma në kopshte privat gjysma në Çerdhe publike, kështu që mendoj se është një ndihmesë shumë e madhe për fëmijët e fshatit Bradash, kështu që pavarësisht buxhetit, ne (Grupi i AAK-së) do të jemi Pro votimit sepse në çfarëdo forme buxheti është mirë që të kalohet.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, në raport me projeksionet me KAB, buxheti tani është më ulët për rreth 295,000.00€, dua të di arsyen përse e që ndoshta drejtori i DBF-së na shpjegon.

Po ashtu më kanë bërë përshtypje disa pika, shembull asfaltimi i rrugëve në fshatin Pollatë, tani pyes a po asfaltohet aty apo po bëhet Diga e Pollatës, e them këtë sepse ka buxhet të ndarë me nga 20,000.00€ për fshatin Pollatë por edhe për fshatin Zhiti. Po ashtu ishte edhe çështja e anekseve të shkollave që i përmendi drejtori, ka rreth 6 muaj që janë duke e përmend aneksin e shkollës ë fshatin Siboc por unë këtu n projektbuxhet nuk e pash. Pastaj më bëri përshtypje shuma për rregullimin e rrugëve me zhavorr në vlerë 200,000.00€, shtrohet pyetja ku janë ato rrugë me zhavorr në këtë shumë prej 200,000.00€, e them këtë sepse shuma është e madhe kurse shumica e rrugëve janë të asfaltuara e që ku do të shtrohet ai zhavorr nuk po mund ta di.

Gjithashtu ishte edhe kodi për rregullimin e infrastrukturës së varrezave në shumë 300,000.00€ e që ka rreth 4-5 vite që është premtuar për varreza por nuk është ndërmarrë asgjë. Po ashtu shumë

m ka bërë përshtypje ndërtimi i tregut të kafshëve e që në çdo buxhet del me shumën me nga 50,000.00€ por që unë nuk e di që është rregulluar ndonjëherë diçka atje, të paktën unë nuk e kam parë, ndoshta edhe është bërë. Mandej e përmendi drejtori i DBF-së infrastrukturën e turizmit, pyes a ka mundësi sakt të më tregoni se çka do të bëhet këtu, e them këtë sepse shembull ta marrim e dimë që janë dhënë shumë para e që janë dy staza të ecjes në fshatrat Shakovicë dhe tek pishat e Pakashicës por që në ato staza veç me ec nuk mundesh dhe këtë e them sepse kam qenë në të dyja këto staza dhe nuk janë kurrfarë stazash por që janë dhënë shumë mjete buxhetore, andaj pyes çka planifikohet të bëhet aty sepse nuk mund të ecet mbi ata shodër aq të trash aty madje as të rinjtë e as askush, për vija e për video gjirime me dron ndoshta po, por si staza për ecje jo.

znj. Arnisa Sylejmani, theksoi, të gjitha mangësitë e këtij buxheti pothuajse i përmenden anëtarët tjerë parafolës të Kuvendit, mirëpo sikurse çdo herë tash e katër vite po bëhet si rutinë, unë tani kam disa pyetje për drejtorinë e DBF-së, e kam parë në këtë dokument se ka shumë shërbime kontraktuese, shembull te pjesë e asamblesë po e kuptoj që shërbim kontraktues është pjesa e medias mirëpo në çdo Drejtori ka goxha shuma të mëdha tek pjesa e shërbimeve kontraktuese siç shembull për kulturë, rini dhe sport mendoj se vetëm ashtu janë sa për ta mbushë atë faqen e exel sepse janë shumë ndihma simbolike. Gjithashtu te arsimi kemi një shumë 50,000.00€ për platformë digjitale në arsim, mirëpo për të realizuar diçka në arsim me 50,000.00€ dhe nëse mendohet të digjitalizohet është diçka absurde kështu që mendoj se është vetëm një mashtrim që është vu aty se sa digjitalizim.

z.Naim Çunaku, theksoi, sot për trajtimin e pikës për miratimin e buxhetit u fol nga të gjithë ne se është një prej pikave më të rëndësishme për një vit kalendarik, gjegjësisht bisedojmë për qesen e Komunës dhe se ku do të investohet paraja publike qoftë nga granti qeveritar qoftë nga të hyrat vetanake, dhe nga granti qeveritar me këtë propozim buxhet kemi 32,420,629.00€, kurse nga të hyrat vetanake kemi 2,358,594.00€, pra u fol deri tani dhe nuk dua t'i përsërisë por që u folën, mirëpo deshta një diçka që në këtë foltore u zë në gojë më shumë se dy herë merakosja për bllokimin e buxhetit që si pasoj do të rrjedhonte me shkurtimin e pagave të nëpunësve civil, por të mos harrojmë se Kuvendi i Komunës edhe po të mos e miraton buxhetin tani, deri më 31 mars të vitit të ardhshëm und të shfrytëzohet buxheti në përpjesëtim me buxhetin mujor të Komunave.

Askush nga gjithë ne që folën këtu nuk e drejtoj alarmin ose shqetësimin se çka do të ndodh nëse buxheti i miratuar nga Komuna jonë nuk kalon si propozim, dhe ligji për buxhetin në Kuvendin e Republikës së Kosovës e ka një afat kohor deri më 31 tetor të këtij viti, dhe afati tjetër kohorë është 31 dhjetori që përfundojnë ndarjet buxhetore, nëse nuk e kemi të aprovuar buxhetin e Republikës së Kosovës, do të thotë që ne nuk mund të bllokojmë paga, nuk mund të bllokojmë shërbime sepse e kemi të paktën që ligji e përcakton që mund të lejohet deri në mars të vitit të ardhshëm, ndërsa nëse buxheti nuk miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të gjitha aktivitetet duhet të pushojnë dhe është alarm deri më 31 dhjetor, dhe këtë nuk e shfaq askush, por thuajse ne jemi ata kryesorët për buxhetin.

Më bëri të flas edhe një diçka që tani e tri vite e ky është viti i katërt që vazhdimisht në këtë foltore e kemi potencuar se ku është Kuvendi i Komunës së Podujevës, sa është i përfshirë Kuvendi i Komunës së Podujevës në përmbushjen e tij ligjore (neni 62) për hartimin gjegjësisht prurjen e projektbuxhetit, kur me 1 shtator Kryetari i Komunës gjegjësisht Ekzekutivi i Komunës kish qenë dashtë t'ia dorëzoi buxhetin Kuvendit, por çka na ndodh neve, ne e dhe pas kësaj date, jo që nuk është dorëzuar, por atëherë fillojnë dëgjimet publike me qytetarët, dhe atë, më 08.09.2025 në Gllamnik, më 09.09.2025 në Dumnicë, më 10.09.2025 në Bradash, do të thotë që nuk ka qenë i përgatitur që t'i dorëzohet Kuvendit dhe mundësia gjegjësisht detyrimi ligjor që e përcakton që Komuna të organizoj dëgjime buxhetore, as që bëhet fjalë, dhe kjo ka qenë ajo që vazhdimisht e ka

përcjellë këtë Ekzekutiv për tri vite me radhë dhe tani për të katërtin herë që kemi para vetës miratimin e buxhetit, do të thotë mos pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje në hartimin e buxhetit dhe mos përmbushja ligjore e Kuvendit Komunal që të mbaj dëgjime buxhetore me publikun, këto janë mundësitë tona si kuvendar, por pa fajin tonë dhe të mos tentojmë që të bëhemi bashkëfajtor në atë që nuk ka qenë kompetencë por e vlen të ceken shkeljet me të cilat po miratohet ose po refuzohet ky projektbuxhet sepse verdiktin do ta merr pas diskutimeve.

Një diçka që më bëri përshtypje është se nga 2.3 milion euro, 1.4 milion euro janë të shpërndara në 51 projekte, dhe atë me vlerë 20,000.00€ deri në 40,000.00€, a mendon që ky parcializim këso fare e buxhetit i kontribuon zhvillimit, mirëqenies, vizionit apo planit prosperues të Komunës, unë mendoj se jo, mirëpo krejt çka mund e arsyeton një kësi parcializimi të investimeve është nëse kemi kalkulime elektorale që vërtetë po ta analizosh në thellësi buxhetin e shoh që është i përmbushur me kalkulime elektorale, por jo një projektbuxhet i cili do të ishte vizioni zhvillimor i ngrijës ekonomike dhe mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z.Ragip Fetahu, theksoi, bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, dhe Rregulloren e punës së Kuvendit unë kam dy propozime që të hyjnë në buxhetin për vitin e ardhshëm;

1-Një rrugë në fshatin Reçicë, në fakt është rrugicë e cila nuk ka emër e që është kërkesë e vazhdueshme e banorëve duke ditur që fshati Reçicë është një atraksion turistik e sidomos gjatë sezonit të verës, pra është pran Kullës së Dem Ahmetit, andaj propozoj të hyjë në projektbuxhet për vitin e ardhshëm me një shumë prej 20,000.00€ për këtë rrugë.

2-Rruga kryesore e fshatit Tërnavicë të vazhdohet me mirëmbajtje sepse rruga sipër e rrugës kryesore është thuajse e pakalueshme andaj për këtë rrugë propozoj që këtë të ndarë një vlerë 10,000.00€, pra për gërryerjen e kanaleve anash dhe shtrimin me zhavorr të pjesës ku ka nevojë.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, sot kemi para vetës projektbuxhetin e Komunës për vitin 2026 i cili kap vlerën afër 35 milion euro, dokument ky shumë i rëndësishëm i cili përcakton prioritetet tona financiare dhe mënyrën se si do të orientojmë zhvillimin e Komunës tonë.

Ky buxhet nuk është vetëm një tabelë me shifra por është një pasqyrë e qartë e vizionit dhe përgjegjësisë tonë ndaj qytetarëve

Tek infrastruktura publike një nga prioritetet kryesore mbetet përmirësimi i infrastrukturës rrugore ku janë paraparë miliona euro për asfaltimin e rrugëve në qytet dhe në fshatra, investime këto të cilat do të lehtësojnë lëvizjen e qytetarëve, do të lidhin më mirë fshatrat me qendrën dhe do të rrisin zhvillimin ekonomik lokal. Po ashtu është paraparë ndërtimi i trotuareve, rregullimi i shtratit të lumit Llap, kanalizimet në zonat rurale si dhe ndriçimi publik në qytet dhe në fshatra.

Tek shëndetësia janë paraparë furnizime barna dhe reagenca, oksigjen, pajisje mjekësore dhe materiale higjienike, dhe po ashtu janë përfshirë projekte kapitale siç janë ndërtimi i objekteve shëndetësore, pajisje për QKMF si dhe blerja e autoambulancave, e që këto investime janë dëshmi e përkushtimit tonë që qytetarët të kenë shërbime shëndetësore cilësore.

Tek arsimi mbetet një prej prioritetëve tona më të mëdha ku parashihet ndërtimi i objektit të ri për shkollën e mesme në kampusin e qytetit, ndërtimi i anekseve në shkollat “Dr. Ibrahim Rugova”, “Enver Maloku” dhe “Xheladin Rekalu”. Pastaj kemi renovimin e institucioneve arsimore si dhe ndërtimin e shkollave të reja në fshatrat Bradash dhe Dobërdol. Pra investimet në arsim janë investime për të ardhmen e fëmijëve tanë.

Në këtë buxhet është paraparë gjithashtu ndërtimi i Zonës Industriale, ngritja e infrastrukturës për turizëm dhe ndërtimi i tregut të kafshëve dhe atij të qytetit. Po ashtu për bujqësi janë paraparë subvencione për perimekulturë, bletari, blegtori dhe mekanizëm bujqësorë, investime këto që po e fuqizojnë ekonominë vendore. Gjithashtu janë paraparë mjete për subvencionimin e aktiviteteve

kulturore dhe sportive, ndërtimin e terreneve sportive si dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, kultura dhe sporti janë dy shtylla që forcojnë identitetin dhe bashkojnë komunitetin tonë.

Të nderuar kolegë ky projektbuxhet nuk është thjesht një plan financiarë por një plan i plotë zhvillimi për Komunën tonë ku ai përmbledhë rrugë të reja, shkolla moderne dhe shërbime shëndetësore më cilësore, mbështetje për bujqësinë, kulturën dhe sportin , pra përfshinë çdo segment të jetës që qytetarëve tanë. Me këtë buxhet ne po dëshmojmë edhe njëherë se jemi në shërbim të qytetarëve dhe se vizioni ynë për Podujevën është vizion i punëve të mëdha, investimeve afatgjate dhe përkushtimit tanë të përditshëm.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, deshta të ndërlidhem te kolegu parafolës z.Ragip Fetahu i cili paraqiti një kërkesë për shtrimin e një rruge pa emër ë fshatin Reçicë dhe me këtë rast dua t'i tregoj të gjithë drejtorëve e në veçanti drejtorit të DBF se ajo që planifikohet, për këtë pushtet prej vitit 2021 e këndej krejt rrugët e Komunës së Podujevës janë pa emra sepse asnjëherë për çdo vit, nga vitit 2021 edhe pse kam kërkuar të specifikohen, sa herë që kemi diskutuar për buxhetin e Komunës, rrugët të cilat do të asfaltohen por që nuk e keni bërë, e arsyeja tani më e dim shumë mirë është se i jep një mundësi pushteti t'uaj për t'i shtruar rrugët në bazë të librezave partiake.

Kështu që vetëm deshta t'i tregoj edhe kolegut parafolës por edhe të tjerëve që për këtë pushtet qysh prej vitit 2021 krejt rrugët e fshatrave të komunës së Podujevës janë pa emra.

z.Ragip Fetahu, theksoi, është e rëndësishme të potencohet se unë nuk e thash që është rrugë por është rrugicë, fillimisht, ndërsa tjetra është se nuk rëndësi se a ka apo nuk emër por e rëndësishme është që të zgjidhen e qytetarëve.

z.Valon Demolli, theksoi, edhe unë deshta të ndërlidhem me kolegun parafolës z.Xhevdet Maloku kur e përmendi Shkollën për Konsulencë apo shkollën Ekonomike në Zonën Industriale, nëpër dëgjime publike ju po i paraqisni si projekte të përfunduara këto andaj nuk e di tani përse duhet të hyjnë në buxhet prap, pra kur në dëgjime publike po i paraqitni të njëjta si projekte të përfunduara.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, faleminderit të gjithëve për diskutimet dhe vërejtjet që jepen për buxhetin dhe atë jo vetëm për vitin 2026 por edhe për krejt brenda këtyre 4 viteve ku kjo asamble komunale e ka diskutuar dhe miratuar buxhetin e që normalisht që miratime kanë qenë me shumicë të votave, por që pjesë e diskutimeve kanë qenë të gjithë dhe padyshim unë besoj se të gjitha diskutimet janë në vazhden logjike të asaj për të mirën e përgjithshme që buxheti të jetë ai që sa më shumë t'iu përgjigjet nevojave të qytetarëve.

Buxheti përgjatë gjitha këtyre viteve ka qenë me rritje ë vazhdueshme dhe nëse flasim për buxhetin e vitit 2022 si buxhet komunal i parë i miratuar kjo përbërje e kësaj asambleje ku ka qenë një buxhet në vlerë prej 23 milion euro ndërsa sot po miratojmë një buxhet në vlerë 34 milion euro e që normalisht se një pjesë e madhe e kësaj rritje ka shkuar në kategorinë e pagave që edhe kjo është shumë pozitive sepse ka pasë rritje të pagave por edhe rritje të punonjësve në sektorin publik ku kryesisht kjo rritje ka ndodh në sektorin e shëndetësisë ku janë mbi 40 të punësuar si rritje në bazë të planifikimeve buxhetore por edhe një pjesë në sektorin e arsimit ku pothuajse të gjithë janë në arsimin parafillor që ka rezultuar me hapjen e Çerdheve të reja.

Ky buxhet është sikur edhe buxhetet e tjera, mirëpo në buxhetin e vitit 2026 dhe vitin 2027 ju ka dhënë prioritet disa sektorëve e që u përmenden këtu sektori i arsimit, shëndetësisë, kulturës, ne kemi një rritje tepër të ndjeshme të buxhetit në fushën e arsimit në rast se e krahasojmë me periudhat paraprake ku tani kemi mbi 2,700,000.00€ investime në fushën e infrastrukturës arsimore dhe gjithashtu rritje të buxheti në kategorinë e mallrave. Në shëndetësi kemi infrastrukturën e që nëse flasim për investime kapitale është një infrastrukturë që me përfundimin e Urgjencës, ndërtimit të QKMF-ve në fshatrat Lluzhan dhe Gllamnik është një infrastrukturë e

rrumbullakësuar dhe tani vetëm kemi ndarje buxhetore që janë vetëm për renovimin e objekteve shëndetësore ndërsa sa i takon ndërtimit normalisht që konsiderohet se u është e nevojshme më.

U përmend këtu që ka edhe mungesë të projekteve zhvillimore, tani në kuadër të këtij buxheti që nëse flasim për investime kapitale është rreth 8,757,000.00€ do të thotë është afër 9 milion euro, janë të projektuara disa projekte zhvillimore qoftë në fushën e arsimit sepse edhe këtu padyshim ndoshta është sektori më i rëndësishëm i shoqërisë, mirëpo në fushën e ekonomisë siç është ndërtimi i Zonës Industriale për të cilën u cekë që pse vetëm 150,000.00€ mirëpo ne jemi në bashkëfinancim me Ministrinë e tregtisë dhe Industrisë ku kjo Ministri i ka të ndara 3.5 milion euro kurse ne jemi vetëm participues të këtij projekti, normale që ne e kemi kryer shpronësimin e tokave në Zonën Industriale dhe çështje të tjera deri te licencimi që janë kryer të gjitha këto procedura e që tani ka mbete vetëm me ndërtim e që janë bërë më shumë se 1 vit që është në procedurë të prokurimit por siç e dimë Ligjin e prokurimit, ankesat, OSHP, Gjykatat ku edhe tani është kjo lëndë, në fakt këtë procedurë e ka zhvilluar Ministria mirëpo për shkak të atyre ankesave ende nuk ka filluar ndërtimi. Në atë Zonë Industriale parashihet edhe fillimi i ndërtimit të Parkut teknologjik që është i planifikuar këtu.

Pastaj investime në infrastrukturën arsimore ku janë të planifikuara në mënyrë që arsimi të kthehet në mësim gjithë ditor. Po ashtu buxhet i mjaftueshëm në fushën e shëndetësisë për kategorinë e mallrave sepse u shtrua pyetje përse ka subvencione në kategorinë e administratës, pra bëhet fjalë për subvencione të cilat janë për mbulimin e shpenzimeve për mbulimin e barnave për personat me sëmundje kronike. Gjithashtu u ceken edhe subvencionet e ndara në kuadër të shërbimeve publike, pra bëhet fjalë për shpenzimet e varrimit që janë në bashkëpunim me Bashkësinë Islame.

Po ashtu te buxheti i inspektoratit bëhet fjalë për rrënimin e objekteve të cilat janë të ndërtuara pa leje apo pengesa të ndryshme të cilat janë nëpër qytet apo përgjithësisht në Komunën e Podujevës.

Sa i përket asaj që u tha se në planifikimet e KAB kemi pas buxhet më të lartë, nuk qëndron ajo sepse është saktësisht ky projektbuxhet ashtu sa ka qenë me KAB, do të thotë është 34,778,954.00€ ashtu sa ka qenë në KAB që është përgatitur në bazë të Qarkores së parë Buxhetore të Ministrisë e që i njëjti buxhet është edhe në Qarkoren e dytë Buxhetore dhe normalisht limite janë në përputhje me Qarkoren Buxhetore të cilën e lëshon Ministria e Financave, kështu që besoj se ky buxhet jemi munduar ta bëjmë më të mirën të mundshme që t'i përgjigjet kërkesave të qytetarëve.

Një element që ceket është se ndoshta buxheti i investuar në arsim e tejkalon ndjeshëm buxhetin i cili do të investohet në vitin 2027 në asfaltim, a zëm në qoftë se buxheti në urbanizëm është 2,302,000.00€, në arsim investimet kapitale janë rreth 2,700,000.00€, do të thotë se është një tejkalim i ndjeshëm kështu që besoj se është një orientim i duhur i politikave ose i investimeve andaj unë ju ftoj që ta mbështetni duke ju falënderuar të gjithëve për kontributin e dhënë jo vetëm në këtë buxhet i cili është i fundit për këtë mandat të kësaj legjislatore të asamblesë komunale, por edhe ju falënderoj për diskutimet përgjatë gjithë këtyre viteve.

z.Naim Çunaku, theksoi, ku flitet për buxhetin e para katër viteve dhe duke bazuar në shifrat që i japi drejtori parafolës i DBF ku atëherë kishim rreth 23 milion euro kurse tani kemi mbi 34 milion euro, por kam një pyetje për drejtorin e DBF, a kemi ndërrim të formulës për ndarjen buxhetore komunale apo është vetëm si rezultat i ngritjes së vlerës gjegjësisht shumë të inkasuar të buxhetit, pra a mund të na tregosh drejtor cila ka qenë fuqia blerëse ose vlera reale dhe sa kanë mund të realizohen me 23 milion euro dhe cila është sot, mirëpo unë po i përmend vetëm disa shembuj që para katër viteve 1 bukë të cilën të gjithë e konsumojmë ka qenë 25 deri në 30 cent, 1 litër vaj ka qenë 70 cent, materiali ndërtimor 1 kilogram hekur ka qenë 95 cent kurse tani e kemi 130 cent, një bllok giter si material ndërtimor nga 18 cent në 27 cent, do të thotë që në kuptimin e vlerës

nominale ne edhe mund të krenohemi që kemi buxhet prej 34 milion euro, ndërsa po të analizosh ne tani jemi më varfër se sa që kemi qenë para katër viteve. Fuqia blerëse dhe realizuese e asaj shume sot është më e pavlerë se sa që ishte para katër viteve, tani shtrohet pyetja qysh po thoni buxheti më i madh e që në një formë është më i pa vlefshëm, këtë po e them për të arsye se të gjithë e dim qysh mbushet buxheti i republikës së Kosovës, në bazë të tarifave gjegjësisht TVSH-së dhe taksave tjera dhe ato taksa kur dhe që një produkt i'u ka ngritë çmimi në treg sigurisht që me automatizëm është ngritur edhe vlera inkasuese gjegjësisht deponuese për buxhetin e Kosovës, mirëpo ta kemi gojën plot duke thënë qytetari, qytetari dhe gjithë ne nëse duan mund ta pranojnë e dim sakt se a është qytetari më varfër tani apo para katër viteve, në kuptimin se e dim qysh e kemi përmbyllë një pagë, e që e përmendi drejtori pagën, nëse ka qenë paga para katër viteve 400€ dhe çka blihet sot me 600€, këtë më së miri e dinë qytetarët varësisht debatit që ne e zhvillojmë sepse e ndjen në kurriz të vetin që qytetari në këto katër vite veç përparuar nuk ka, por është i varfëruar.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, deshta vetëm të reagoj njërit prej parafolësve (*fjala është për z.Valon Demolli*) i cili më përmendi e që fillimisht e them që ai nuk më paska dëgjuar fare se çka kam fole unë këtu, si asnjëherë që nuk dëgjojnë kurrë, çfarë konsulence a çka je duke thënë, nuk e di kush e përmendi atë fjale.

Po ashtu jeni duke mu drejtuar mua sikur unë të isha pjesë e Ekzekutivit të Komunës por po harron që unë jam njëjtë sikurse ti anëtar i Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore 2027-2028, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes si dhe propozimet e dhëna në fjalën hyrëse të kësaj pike por edhe atyre përkatëse në vazhdim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 31 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 20 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet Propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore 2027-2028, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, si dhe plotësim ndryshimeve apo përmirësimeve teknike të paraqitura nga drejtori i DBF në fjalën hyrëse dhe ato përkatëse në vazhdim, plotësim ndryshime të cilat përgatiten nga DBF dhe dërgohen në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit për t'u proceduar tutje.

3. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale- “Eko-Llapi” Sh.A

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, arsyetimin e këtij propozim vendimi e bëra në hyrje të kësaj mbledhje kur e propozova të hyjë në rend të ditës, kështu që tani vetëm propozoj të miratohet ky propozim vendim dhe të ndahen këto mjete buxhetore për NPL “Eko-Llapi”.

z.Naim Çunaku, theksoi, kur kemi të bisedojmë për NPL “Eko-Llapi” sigurisht që të gjithë ne këtu jemi dëshmitar që LDK gjegjësisht Grupi i këshilltarëve të LDK-së e ka mbështetur propozimin për aktin themelues të Ndërmarrjes “Eko-Llapi” dhe e kemi parë edhe atëherë dhe e shohim edhe tani si nevojë që NPL “Eko-Llapi” si ndërmarrje komunale kish e qenë shumë më e përdorshme për shumë aktivitete që kërkojnë brenda Komunës, mirëpo duke pasë parasysh që është më shumë se njëherë që jemi duke ndarë mjete buxhetore për këtë Ndërmarrje dhe atë pa

specifikim se pse, ku dhe për cilën arsye, ne na bëri që edhe në fillim të mbledhjes kur u propozua si pikë shtesë e rendit të ditës, edhe tani të mos marrim pjesë në një votim sepse Ndërmarrjet publike njëherë e mirë duhet të mësohen që duhet të funksionojnë në bazë të të hyrave që gjenerojnë për punët gjegjësisht për aktivitetet që ata bëjnë, dhe nëse ne vazhdojmë kështu që të përkrahim NPL “Stacioni i Autobusëve”, NPL Banesor, Ujësjelesin, Pastrimin, atëherë ne në një formë buxhetin i cili është i dedikuar për investime kapitale gjegjësisht për investime me projektbuxhet për Komunën tonë, jemi duke i kthyer tek Kompanitë publike, dhe jemi duke bërë një padrejtësi se të gjitha ato kompani publike për shërbime e veta dhe aktivitetin e vet arrijnë të inkasojnë taksë, dhe njëherë ata e paguajnë drejtpërdrejtë çmimin e shërbimit një Kompanie ndërsa herën e dytë ne duke i dhuruar buxhet komunal po bëjmë pagesë të dyfishtë, andaj në këtë kontekst ishte ajo që LDK edhe kur herën e fundit kur kemi votuar për dhënien e mjeteve subvencion për këto Ndërmarrje publike, ta kuptojmë njëherë e mirë që nuk mundet në vazhdimësi buxheti i Komunës t’iu shkon gratis apo si të themi ndryshe të i’ua bulon mos menaxhimin e suksesshëm të Ndërmarrjeve Publike, prandaj kjo është arsyeja që duhet t’i mësojmë ata sepse janë Ndërmarrje vet financuese dhe duhet të qëndrojnë të vet financuar dhe të funksionojnë si Ndërmarrje të suksesshme për shërbimet që ata bëjnë.

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim ndarjen e shumës prej 30,000.00€ për subvencionimin e NPL “Eko-Llapi”.

z.Burim Hasani, theksoi, Ndërmarrja Publike Lokale “Eko-Llapi” e dim që është themeluar në këtë mandat dhe është duke kryer punë të mira dhe çdo herë jemi duke e rritur aktivitetin edhe zgjerimin e punëve shtesë, në këtë muaj kemi filluar me zgjerimin e një game të punëve duke filluar me ndriçimin, së shpejti do të fillojmë edhe me parkingjet publike dhe me punë të tjera, po ashtu kjo Ndërmarrje në këtë vit ka kryer punë të mira siç janë renovimi i Çerdheve, shkollave, mirëmbajtjen e parqeve, rrugëve e të tjera, mirëpo është Ndërmarrje e re donë financim dhe donë mbështetje nga Komuna, kështu që nga AAK e përkrahim ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë 30,000.00€ për NPL “Eko-Llapi” në Podujevë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, shqyr Kryesues që është seanca jote e fundit dhe nuk të shohë më këtu, boll shumë gëzona. Është dashtë që kjo Ndërmarrje të vijë këtu dhe të raportoj në mënyrë që ne të dim se çka do të bëhet me këto mjete, e dim që herën e fundit e kanë marr nën menaxhim edhe parkingun në afërsi të komunës së vjetër por aty ende po vazhdojnë të punojnë njerëzit e njëjtë e që nuk e dim as çfarë të hyrash kan as asgjë.

Parafolësi e tha që po pastrojmë shkollat, po dezinfektojmë e të tjera, ne e dimë që nuk ka asnjë njeri aty që është i trajnuar për dezinfektim, nuk është lojë ajo që të dezinfektohen shkolla e luhet me nxënës nga persona që nuk janë të trajnuar në atë fushë sepse ajo është goxha lëmi e rëndë dhe e vështirë. Po ashtu kjo kompani nuk po i publikon Kontratat e nënshkruara mes Kryetarit të Komunës dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes, e them këtë sepse gjysmën e punëve që i përmendi parafolësi ato janë punë të kontraktuara me Kompani tjera private, pra nuk mund të shkosh të pastrosh trotuare kur i ka marrë ai (Kompania private e kontraktuar) mbi 570,000.00€ për atë punë, për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve, pra nuk mund t’ia kryesh punët ose t’i bëhesh argat një kompanie private, ose përndryshe ti mund t’i pastrosh trotuaret kurse faturat i merre ajo Kompani e cila e ka marrë kontratën sepse e ka nënshkruar atë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i nderuar zotëri Ekrem ti çdo herë po reagon që nuk po të jepet fjala, mirëpo këtu nuk është vetëm VV dhe LDK për t’jua dhënë fjalën por janë edhe Partitë tjera dhe edhe ato janë në rend, pra zotëri Burim Hasani nga AAK ishte para teje që kërkoi fjalën, përndryshe nuk ke nevojë të ngutesh duke kërkuar fjalën në atë mënyrë sepse asgjë për ngut nuk jemi.

z.Burim Hasani, theksoi, i nderuar kolegë z.Ekrem Rrahmani, është mirë të fokusohemi sepse unë dezinfektim nuk përmenda, edhe pse me dezinfektim do të fillojmë shumë shpejt por edhe nëse kërkohen të jenë njerëz specialistë ne e kemi ndarjen e buxhetit për të kontraktuar shërbime nënkontraktuale ku do të marrim licencë nga veterinarë të specializuar për këtë fushë, kurse sa i përket renovimeve nuk e di sa jeni në ngjarje i nderuar sepse renovimet janë duke ndodh në Çerdhen në fshatin Orllan si dhe në shkollë ë ndryshme.

Sa i përket raportimit, në vitin 2025 asnjë prej Ndërmarrjeve Publike nuk ka raportuar, përjashtim NPL “Eko-Llapi” kështu që për këtë Ndërmarrje e kam pasë raportimin e rregullt qoftë vjetor qoftë gjashtëmujor, nëse ju duhet diçka shtesë mund t’i dërgoj edhe në e-mail.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë nuk e di kush e ka rinovuar që u pamend Çerdhja në Orllan nga parafolësi, por e di që shkollë ka qenë e ndërtuar dhe vetëm një klasë është ndarë aty ku janë bërë disa vizatime, çfarë renovimi është ai, nuk mund t’i thuash renovim një klase në të cilën bëhen disa vizatime dhe shndërrohet në Çerdhe.

Sa i përket dezinfektimit, unë nuk e thash se ku do të trajnohen ata punonjës, por e thash që njehe përnjëherë nuk ka NPL “Eko-Llapi” punëtorë të trajnuar për dezinfektim, pra nuk e thash që nuk do të trajnohen kurrë dhe nuk do të bëhen kurrë, por unë të tregova që tani për momentin nuk ka, përndryshe t’i të raportosh duke thënë se është kryer kjo punë e ajo punë ajo është sipërfaqësore.

Raportim është këtu ta dimë se çfarë Kontratash janë nënshkruar, sa para janë marrë, cilat punë i ka kryer “Eko-Llapi” punë konkrete që nuk janë në kontratë me Kompanitë private, por i kryen vet “Eko-Llapi” dhe i merr paratë, këtë e thash unë.

z.Naim Çunaku, theksoi, e mora fjalën për sqarime por meqë e filluam me urime e përgëzime nuk kam si ta mos e përgëzoj kolegun parafolës (z.Burim Hasani) i cili është anëtar i bordit, dhe po harrojmë që deri sa ne i dëshiruam njëri tjetrit se ky është përfundimi i mandatit e ai mandat i përfundon edhe zotëri Hasanit bashkë me mandatin e Kuvendit. I’a vlerësoj përpjekjet e tij që gjithmonë ka fol në emër të NPL “Eko-Llapi” por vërtetë kjo Ndërmarrje dihet se ka një Drejtor Ekzekutiv dhe e ka një Bord si dhe është e vërtetë shumë e madhe ajo që Ndërmarrjet tjera publike ku ne jemi aksionarë nuk kanë raportuar, përkundër që një raport edhe pse i mangët është sjellë nga Ndërmarrja “Eko-Llapi”, mirëpo ajo që kjo Ndërmarrje po shndërrohet duke thënë se e zgjeruar gamën e veprimtarisë dhe çka kemi bërë është se kemi marrë asete komunale nën menaxhim për krijimin e të hyrave për Ndërmarrjen dhe ajo ka ndodh këtu me zyrën që i është dhënë në qendër të qytetit e cila vërtetë që është tërheqë nga privatizimi dhe vërtetë ajo zyrë, ai lokal edhe sot e kësaj dite edhe pse kemi vendim të Kuvendit, nuk ka kaluar në menaxhim në menaxhim të Ndërmarrjes “Eko-Llapi”, pastaj kemi një parking për të cilin kemi pas dilemat tona dhe kemi votuar kundër sepse është i pasqaruar parcela brenda aty që është mbi 30 ari se nuk mund të realizohet. Tani unë po i’u them të gjithëve duke përfshirë edhe kolegun parafolës z.Burim Hasani dhe gjithë atyre të Ndërmarrjes “Eko-Llapi” që për dhënien e pronës në shfrytëzim kompetent është Kuvendi i Komunës dhe nuk mund të zgjerojnë kurrfarë kapacitetesh apo veprimtarish në kurriz të pronës komunale, dhe të gjitha ato shërbime që i bëjnë ata hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me autoritetin e Komunës dhe për atë marrin shpërblimin nga Komuna, por jo të marrin ndarje buxhetore prej Kuvendit pa specifikë se ku kanë punuar, çka kanë punuar dhe çfarë marrëdhëniesh kontraktuale ka Komuna jonë në këtë rast me Ndërmarrjen “Eko-Llapi” të cilën e ka ndërtuar vetë.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, t’ju them të drejtën nuk e prita që po ngjall gjithë ky debat për një ndarje buxhetore për NPL “Eko-Llapi”, temë për të cilën sqarime janë edhe në propozim vendimin përkatës, pra bëhet fjalë për rritjen e kapitalit punues, pra të gjitha nuk janë cekë në propozim vendim por kryesisht është kërkesa e kësaj Ndërmarrje për një eskavator si dhe

normalisht ta rritë gamën e shërbimeve kjo Ndërmarrje e cila normalisht se me vendimin e Kuvendi të Komunës kur është themeluar e ka se çfarë e ka sakt veprimtarinë mirëpo për të gjitha ato çfarë janë me vendimin e Kuvendit kjo Ndërmarrje ende nuk i ka kapacitetet e saja as të kapitalit as kadrovike që t'i kryej komplet ato shërbime të cilat i ka edhe me vendim të Kuvendit e që duhet se Ndërmarrja komunale themelohet edhe me vendim të Qeverisë mirëpo edhe që i ka të regjistruara në ARBK, pra për ato ajo Ndërmarrje ka autorizim me vendim dhe edhe është e regjistruar për ato shërbime mirëpo që ende nuk ka arritur t'i kryej.

Ndoshta të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës e kanë parë punën e NPL "Eko-Llapi" edhe është parë si një dorë e djathtë e qytetit ku është duke i kryer shumë shërbime edhe në mirëmbajtjen e hapësirave publike, edhe në mirëmbajtjen e institucioneve arsimore dhe shëndetësore deri te shërbimet tjera që janë më të vogla që është edhe shërbimi i larjes së automjeteve, kështu që pa dashur të hyjë në çështje të një raporti të kësaj Ndërmarrje e që normalisht se është çështje e vetë Ndërmarrjes, mirëpo prej punës së DBF dhe çështjeve tjera që vijnë ka një kursim shumë të mirë financiar të buxhetit të Komunës së Podujevës si rezultat i funksionimit të Ndërmarrjes Publike "Eko-Llapi", kështu që unë ju ftoj ta mbështetni këtë vendim që ka të bëjë me planin e tyre për blerjen e një eskavatori që të arrihet t'i kryej edhe disa shërbime shtesë kjo Ndërmarrje.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar drejtor i DBF që në fillim e thash se Ndërmarrja "Eko-Llapi" që nga fillimi ka pasë mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe të gjithë e kemi parë si të arsyeshme dhe të nevojshme ta kemi, këtu jemi të kuartë, pra të mos mbetet që dikush e ka kundërshtuar këtë si Ndërmarrje, por shkojmë pak më mbrapa kur unë e kam biseduar kur kemi diskutuar këtu për kontratën që është në mes Bashkësisë Islame dhe Komunës së Podujevës për shërbimet e varrimit, unë konkretisht kam propozuar që shërbimin e hapjes së varrit, t'ia zgjerojmë gamën e punëve Ndërmarrjes "Eko-Llapi" dhe të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale për hapjen e varrezave ashtu siç e ka Prishtina, Ferizaj dhe shumë komuna tjera, çka po dua të them me këtë është se unë kurrë dhe asnjëherë nuk jam që t'i ngushtohet veprimtaria ose ta ndajmë rritjen e Ndërmarrjes "Eko-Llapi" sepse fundja është Ndërmarrje e jona dhe këtu jemi të kuartë, mirëpo duhet ta mësojmë që Ndërmarrja "Eko-Llapi" të qëndroj financiarisht vet e jo duke vjelë buxhet në këtë formë me vendim të Kuvendit por duke e korrë produktin e shërbimit që i ka bërë qytetarit, këtu ishte poenta.

Ndërsa një diçka që më bëri të replikoj më së shumti është se raporti i punës së kësaj Ndërmarrje është punë e vet NPL "Eko-Llapi", jo jo sepse ky Kuvend është themelues i kësaj Ndërmarrje dhe e ka për obligim ligjor sikurse dhe çdo Ndërmarrje tjetër Publike e cila është e themeluar nga Kuvendi, e ka për obligim të raportoj para këtij Kuvendi për gjendjen ekonomiko financiare dhe aktivitetin që është duke vepruar.

z.Kasib Bashota, theksoi, Ndërmarrja Publike Lokal "Eko-Llapi" po na bënë krenar gjithë Llapin dhe është duke bërë një punë të jashtëzakonshme. Ne e dim që kjo Ndërmarrje ka filluar punën që pak kohë dhe nuk shumë mbështetje, madje unë jam që asaj ti ndahen 100,000.00€ ndoshta e jo 30,000.00€ në mënyrë që të fuqizohet sepse po na bënë krenar gjithandej, prandaj duhet ta mbështesim dhe ta fuqizojmë, mandej kur t'i merr këmbët të vazhdoj edhe me inkasimet e veta sepse edhe buxhetit komunal i'a ka zvogëluar paksa barrën buxhetore ngase Komuna po paguan më pak buxhet tek NPL "Eko-Llapi" se sa tek operatorët ekonomik privat.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, e falënderoj parafolësin i cili pati vullnet që Ndërmarrjes në fjalë t'i ndahen 100,000.00€ por do të duhej më herët të kërkonte nga drejtori i DBF që të rritet ajo shumë në 100,000.00€ e jo tani sepse është vonë mendoj, kështu edhe njëherë faleminderit i nderuar z.Kasib Bashota sepse gjithëherë ke qenë i hapur, i gjymert dhe bujar.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, megjithëse zemërgjerësia e këtij pushteti dhe që janë shumë bujar e dim ne sepse sikurse t'i i nderuar kolegë (z.Kasib Bashota) është edhe Kryetari i Komunës i cili pa pasë fonde fare vazhdon e ndanë fonde pa planifikim, prandaj ato 100,000.00€ mund t'ia kërkosht Kryetarit tuja por dyshoj që i ka dhe as nuk do t'i ketë.

z.Valon Demolli, theksoi, deshta të ndërlidhem tek Kompania “Eko-Llapi” e që po bëhen rreth 3-4 muaj kur kam kërkuar qasje në dokumente zyrtare në financa, gjendjen, kontratat dhe për pagesat e bëra Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” që ka të bëjë me mirëmbajtjen e hapësirave publike. Nderuar drejtor, Kompanitë e njëjta e kryejnë punë e njëjtë, ndërsa tri Kompani i paguani ju për mirëmbajtjen e hapësirave publike, pra e ke NPL “Eko-Llapi”, Kompaninë “Eing” dhe Kompania “Pastrimi”, pra për një punë paguhen këto tri kompani, andaj i nderuar drejtor, me keqardhje po të them sepse t'i në një mbledhje më parë në këtë Kuvend ke thënë se je shumë transparent, por i kam e-mailet këtu, prandaj pyes përse nuk më lejohet qasje në dokument zyrtare që rreth 3-4 muaj, e mendoj se kjo e ka vetëm një emër, veç hajni, asgjë tjetër.

Gjendjen e “Eko-Llapi” unë nuk mund ta di përderisa ju mi fshehni të dhënat dhe pagesat që i kam kërkuar prej vitit 2021. Unë jam duke u shtyrë me Agjencinë e Informacionit dhe Privatësisë përmes e-maileve zyrtare, këtë e din edhe ti sepse je në CC në e-maile, kështu që edhe do të donim ta dimë gjendjen financiare të kësaj Kompanie, por kësaj nuk mund t'i ikni sepse unë do të vazhdoj dhe pagesat dhe kontratat për këto tri kompani dhe kompanive tjera publike do t'i publikoni.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, po kyçem tani në fund të këtij debati mirëpo më bërë shumë përshtypje çështja që u diskutua prej disa parafolësve duke thënë që janë disa kompani private që janë duke kryer të njëjtat punë me ato që i kryen Ndërmarrja “Eko-Llapi”, mirëpo unë ju them se kur është bërë Memorandumi dhe Marrëveshja me NPL “Eko-Llapi” janë shikuar me detaje të gjitha projektet apo mirëmbajtjet që janë në domenin e operatorëve privat derisa të përfundojnë ato kontrata dhe kanë hyrë te fushveprimtaria e “Eko-Llapi”. Tani u përmend edhe kompania “Eing” e cila ka një Kontratë ende të hapur publike, mirëpo asnjë hapësirë e cila është në Kontratën e “Eing” nuk mirëmbahen nga “Eko-Llapi” apo e kundërta, dhe këtë mund ta shihni dhe po ashtu mund t'ju jap edhe dokumentacionin ku mund të shihni se çfarë mirëmban Eko-Llapi” e që nëse e keni parë këtë Ndërmarrje “Eko-Llapi” ndonjëherë duke mirëmbajtur sheshin e qytetit, nuk e keni parë sepse nuk ka ndodh ajo ngase “Eko-Llapi” nuk e mirëmban sheshin e qytetit, nuk i mirëmban rrugët e as trotualet në qytetin e Komunës së Podujevës, mirëpo i ka hapësirat publike siç është shembull Parku i Pishave që nuk është në Kontratë me kompanitë private, pra si një prej parqeve që mirëmbahet më shumë prej NPL “Eko-Llapi”.

Sa i përket Kompanisë “Pastrimi”, ajo e ka shumë të kufizuar fushveprimtarinë e vet dhe kryesisht, ashtu siç e ka në kontratë merret vetëm me mbledhjen e mbeturinave përreth shportave të mbeturinave, asgjë më shumë. Pra kontratat janë të ndara dhe nuk asnjë fushëveprim të njëjtë që merren këto tri kompani që u ceken por i kanë të gjitha fushat e ndara, territoret e ndara e që jeni n dijeni se Komuna e Podujevës e ka një territor shumë të gjerë dhe nuk mundet ta mirëmban asnjë kompani, e as NPL “Eko-Llapi” mirëpo derisa të forcohet kjo Ndërmarrje me kapacitet ku edhe tani p[ro]kërkohen këto mjete buxhetore, por edhe për mirëmbajtje të tjera besoj që në kontratat e radhës nuk do të kemi operator privat sepse përgjegjësia do të kaloj në NPL “Eko-Llapi” e cila dita ditës po forcohet më shumë dhe po e merr primatin e një Kompanie serioze krahasuar edhe kompanie e Komunave tjera.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, drejtori parafolës e ceku se NPL “Eko-Llapi” e ka veprimtarinë e caktuar dhe e tha që sheshi i qytetit nuk mirëmbahet prej kësaj Ndërmarrje, mirëpo këto që po prezantoj me foto nga ueb faqja zyrtare e NPL “Eko-Llapi” është duke mirëmbajtur sheshin.

Do të thotë se drejtori parafolës e tha që nuk e mirëmban sheshin kurse këtu e kam me fakt / foto duke e mirëmbajtur disa pjesë të sheshit të Podujevës.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, e përcjellë edhe unë shumë ueb faqen e “Eko-Llapi” dhe e di atë, por e thash edhe njëherë se për të qenë shumë i qartë dhe secilin fushëveprim që e ka një Ndërmarrje private nuk e NPL “Eko-Llapi” dhe tani atë prashitje apo krasitje që e ka Ndërmarrja “Eko-Llapi” shikojeni a po mund ta gjeni ndokund që i kanë kompanitë private, e thjesht është kjo punë, kompania private nuk e mirëmban sheshin por vetëm e lanë / pastron, për shkak se pamundësisë për ta bërë Ndërmarrja “Eko-Llapi” e cila nuk e ka këtë mundësi, përndryshe në kompanitë privat nuk ka as krasitje, as prashitje e as ujitje të pemëve.

z.Valon Demolli, theksoi, unë këtu i kam tri foto të tri kompanive që u ceken të cilat e bëjnë krasitjen e barit në hapësirat publike (Kompania “Pastrimi”, Kompania “Eing” dhe NPL “Eko-Llapi”), pra të njëjtat, punën e njëjtë e kryejnë, andaj nuk e di çka është gjithë kjo frikë, përse nuk mi dërgoni pagesat dhe kontratat, qe katër muaj i kam kërkuar me e-mail i nderuar drejtor i DBF, përse nuk mi dërgoni, përse duhet të vije unë në zyre tek ju, dërgomi në mënyrë elektronike dhe jemi në rregull, përndryshe unë presë të mi dërgosh edhe pse janë bërë 4 muaj prej që kam kërkuar.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, NPL “Eko-Llapi” është treguar si një Ndërmarrje shumë e suksesshme dhe si një storje suksesi e Komunës së Podujevës, andaj çdo sulm që bëhet ndaj saj duhet të jetë e faktuar, sidomos këto sulme në mungesë të dokumenteve mendoj se nuk i bëjnë mirë reputacionit të Eko-Llapit” në krahasim prej disa Komunave tjera ku është munduar të shuhen Ndërmarrjen Publike, Komuna e Podujevës e ka krijuar një Ndërmarrje e cila po del të jetë shumë e suksesshme e për këtë besoj duhet të jemi krenarë gjithë pozitë opozitë.

Për fund, mënoj se ky është fjalimi im i fundit në këtë mandat, andaj dua t’i falënderoj të gjithë për këtë bashkëpunim, Ekzekutivin e Komunës, kolegët anëtarë/e të Kuvendit, kurse një falënderim i veçantë shkon për Zyrë Ligjore e cila kryen edhe punët e Kuvendit Enis Shehollin dhe Sabedin Namanin por edhe Osman Bajramin dhe të tjerët të cilët kanë qenë jashtëzakonisht korrekt sidomos me neve.

z.Valon Demolli, theksoi, konsideroj se suksesi i vetëm i Ndërmarrjes “Eko-Llapi” është punësimi i militantëve, pra ky është suksesi i vetëm, po të ishte kjo Ndërmarrje aq e suksesshme nuk e di përse në çdo seancë thujse duhet të ndajmë mjete buxhetore për këtë Ndërmarrje, pra ky është suksesi i vetëm i asaj Ndërmarrje punësimi i militantëve, kurrfarë suksesi tjetër nuk ka.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, nuk e di ku po e sheh at sulm kolegu parafolës zotëri Mulliqi sepse ne nuk e sulmuam asnjëherë Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko-Llapi”, mirëpo ishte çështja tek sqarimet për punën e kontratave dhe pagesave të cilat nuk na janë dërguar për të cilat kolegu zotëri Demolli ka kërkuar si dhe për disa sqarime për aktivitetin e tyre.

Veç të tjerave po ashtu ju sqaroj unë se atë Ndërmarrje nuk e ka themeluar Komuna, por Kuvendi i Komunës duke përfshirë edhe votën e LDK-së.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ka të tjerë anëtarë/e të Kuvendit që dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të prezantuar në fillim të mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 27 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 15 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të mbledhjes.

4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti “Furnizim me Pajisje për Blegtori”

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, bëhet fjalë për shtim të buxhetit dhe hapje të kodit të ri buxhetor për realizimin e projektit për pajisje për blegtori ku bëhet fjalë për 12,597.00€ nga participimi i fermerëve me qëllim të realizimit të projektit për fermerët, andaj kërkojmë që të miratohet edhe ky propozim vendim.

z.Naim Çunaku, theksoi, dua të shpreh qëndrimin e Grupit të LDK-së, që prej fillimit të këtij mandati Grupi i LDK-së ka qenë kundër participimit të vënë në këtë masë. E di që është bërë shumë zhurmë, e di që është bërë edhe nëpër debate dhe dëgjime publike, por ta kemi të kjashtë se në këtë formë se si është subvencionohet bujku është jashtë asaj që kemi dashtë të subvencionohet bujku, se sa është e rëndësishme kjo është edhe fakti që as edhe prezent nuk e kemi këtu drejtoreshën e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, as nuk përmendet arsyeja as asgjë por mungon në seancë që të jep arsyetimin përse nevojitet të votohet ky kod shtesë.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahi këtë shumë prej 12,597.00€, dhe t’ju them të drejtën kjo pagesë daton nga koha e LDK-së, nuk është nga koha e LVV-së, pra kjo pagesë prej 30% daton nga koha kur ka qenë në pushtet LDK, dhe unë në emër të Grupit kam thënë, mund t’i gjeni edhe në procesverbale që në të ardhëm jam për ta heqë këtë participim qoftë përmes Rregullores nuk e kemi fare këtë problem si Grup, por në të njëjtë kohë edhe kur është nxjerrë Rregullorja ashtu është paraparë dhe kam qenë dhe do të jem gjithherë kundër punës dhe kundër rregulloreve për arsye se ajo është një jetë shkurtër e cila mund ta dëmtoj edhe individin, edhe asambleistin e dëmton edhe Ekzekutivin dhe secilin, pra dua të them se prap në të ardhmen në emër të Grupit do ta japim mbrojtjen dhe përkrahjen kushdo që inicion kjo rregullore të ndryshoj, të hiqet participimi dhe ne LVV fare nuk e kemi problem, mirëpo në këtë moment qëndron kështu siç është. Prandaj kjo pra është e vërteta dhe në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë shumë prej 12,597.00€.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, parafolesë profesori ndoshta ka harruar por Rregullorja e subvencioneve me 21 vota Për, ne Grupi i LDK-së nuk kemi qenë Për, mund ta shihni në procesverbal dhe nëse më jepni kohë 5 minuta unë mund t’ia dërgoj dokumentin.

Pra Rregullorja për subvencione është miratuar në vitin 2022, në këtë legjislaturë të fundit që jemi. Kjo ishte vetëm sa për sqarim por nëse ndokush dëshiron dokumentin unë mund t’ia sjellë atë ku edhe vërtetohet ajo që e thash.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, shikoni të nderuar, sa po kemi propozime të tilla për shtim të buxheti dhe kod të ri për projekte të ndryshme, diskutime po zhvillohen për Rregullore të subvencioneve, përndryshe ne e kemi miratuar atë Rregullore dhe nuk ka pasë asnjëherë iniciativë për ta ndryshuar atë Rregullore, andaj të kthehemi në temë e jo të diskutojmë për diçka jashtë teme sepse nuk e kemi Rregulloren e subvencioneve temë e që sa herë po kemi propozime të tilla ne vazhdimisht po diskutojmë për atë Rregullore.

z.Naim Çunaku, theksoi, nëse unë e përsëriti është karakteri im, përndryshe dua të jap një sqarim për parafolesin z.Haki Rudari dhe për opinionin publik, madje e di që edhe në debate televizive është kalkuluar në forma të ndryshme sa i përket asaj se kush e ka miratuar këtë Rregullore, pra të jem i kjashtë para opinionit publik dhe për kolegun zotëri Rudari, Rregullorja për ndarjen e subvencioneve është miratuar më 29.04.2022, në procesverbalin e miratimit të kësaj Rregullore figuron që Grupi i LDK-së ka qenë Kundër, andaj sot nuk mund të pretendohet se këtë rregullore e kemi trashëguar prej LDK-së. Nëse zotëri Rudari dëshiron ta dijë se kur është vu për herë të parë participimi i fermerëve në subvencione, dhe mund të jetë ashtu siç po thotë zotëri Rudari që para këtij mandati, por ne po flasim për mandatin tim që kam tani dhe nuk mund të paguajmë fatura dhe

nuk jap llogari për diçka që unë nuk kam votuar, prandaj ne jemi duke e cilësuar, edhe njëherë po e them që të jemi të kjashtë para opinionit publik, prej fillimit të këtij mandati Grupi i LDK-së asnjëherë as nuk e ka përkrahë participimin në këtë masë dhe kur është miratuar Rregullorja për ndarjen e subvencioneve më 29.04.2022 kemi qenë kundër, kjo është e vërteta.

z.Haki Rudari, theksoi, unë i kuptoj kolegët sepse tani është fushatë dhe mundohen për të marrë ndonjë votë dhe nuk jam kundër asaj, por nëse LDK është në Komunë prej vitit 2021-2022 mund të pajtohesh, mirëpo sa e di unë LDK ka udhëheqë 20 vite më herët dhe nëse këta shkëputen kaq lehtë nga LDK këta nuk dalin mirë sepse kjo është fyerje për qytetarët dhe është fyerje për ata që e kanë votuar LDK-në më parë e që unë kam shumë respekt edhe për të kaluarën e tyre, por në kohën e LDK-së ka pasë participim për bujqësi dhe kjo është e sakt.

Tani po dua të them edhe një diçka tjetër edhe pse nuk deshta të hyjë në debat, a mund të më tregoj ndokush prej LDK se cili ka qenë propozimi i tyre në projektbuxhet, asnjëherë, ndërsa mund t'i nxjerrni procesverbalet kur unë kam qenë shef i Grupit të LVV-së bashkë me z.Bahri Selimin dhe znj.Adelinë Stublla, mund të shihni se çdo herë kur kemi shqyrtuar projektbuxhet ne kemi bërë propozime dhe nëse ato propozime kanë kaluar dhe kanë hyrë në projektbuxhet ne e kemi përkrahë atë, nëse nuk kanë hyrë në projektbuxhet vetëm i kemi thënë mirupafshim ose kaloni mirë, nuk kemi votuar, pra çdo propozim që ka qenë dhe që është marrë për bazë ne në atë kohë ne e kemi përkrahë buxhetin, janë procesverbalet, mirëpo kjo nuk ka ndodh kurrë në kohën e LDK-së, madje edhe në pikën paraprake e vërejtja e që nuk deshta të ndalem, u tha mangësi, unë pyes cila është mangësi dhe si mund t'i thuash mangësi një projektbuxheti i cili ka gjithë ato projekte e atë buxhet.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari zotëri Rudari unë nuk dua të ngriti zërin sepse fuqia e zërit nuk e fuqizon argumentin dhe me qetësin më të madhe po të them që nëse për këto katër vite ke miratuar buxhet dhe nëse në të gjitha këto ka shkelje ligjore, çka kemi për të propozuar ne kur ka shkelje ligjore dhe nuk lejohet të votohet, apo të bëjmë një shmangie ose ë bëhemi bashkë shkelës. Pra meqë u kërkuar përgjigje nga LDK ju them se LDK kurrë dhe asnjëherë nuk do të bëhet pjesë e shkeljeve ligjore, e që në këtë aspekt edhe më parë t'i përmenda nenin 61 dhe 62, andaj këto na kanë bërë që të mos e votojmë buxhetin, prandaj nuk mund të thuash, dhe kemi rastet më të freskëta sepse fundja secili subjekt politik ka arsyet e veta kur voton Për ose kur voton Kundër, por kur i thua dikujt se je në fushatë, shtrohet pyetja a je edhe ti në fushatë sepse ne të gjithë jemi në fushatë dhe fushata është për të gjithë.

z.Haki Rudari, theksoi, ju e dini që unë jam i hapur për debat dhe nuk e kam fare problem, por për një debat vërtetë të mirëfilltë dhe për një debat të vërtetë sepse këtu nuk jemi në ndonjë aheng e as ndonjë dasëm, por jemi në Kuvend Komunal ku und të debatojmë secili me argumente por jo me përgojime, unë jam kundër përgojimeve. Unë e thash që kjo që po bënë LDK për besë për mua si shef i Grupit të LVV-së dhe si subjekt goxha më jep penalla dhe goxha krijojnë penalla, por po dua të them se unë asnjëherë nuk i iku Vetëvendosjes prej vitit 2013 që LVV është në asamble, unë Haki Rudari kurrë nuk i iku Vetëvendosjes edhe kur e ka mirë edhe kur e ka keq, ne kemi zingjir të lidhjeve, kurse tek ju po e vërej një ikje nga një periudhë 20 vjeçare, kurse të thuhet se vetëm këto 4 vite jemi LDK, këtu është problemi.

znj.Edona Shabani, theksoi, prej që jemi në këtë mandat jeni duke thënë 20 vite, 20 vite, LDK, ju LDK, mirëpo i nderuar Haki unë jam që 4 vite që kam hyrë këtu nga momenti i dhënies së betimit deri tani, kurse sa i përket 20 vite ti po i'a humb edhe 3 vite Kryetarit të Komunës sepse ai 23 vite ka qenë, prandaj kur don të marrësh përgjigje për ato 20 vite e ke Kryetarin e Komunës për të cilin të garantoj me jetë që t'i jep të gjitha me gjitha sistemet.

Unë fola si LDK sepse ashtu u atakuam, dhe të lutem i nderuar Kryesues fjalën mos ma ndal më ngase i kam të gjitha të drejtat e botës për të thënë atë që mendoj.

z.Valon Demolli, theksoi, deshta të ndërlidhem me shefin e Grupit të LVV-së, i them se askush nuk po e mohon të kaluarën mirëpo ky po luan njëfarë themeluesi të LVV-së, por ky po harron që në vitin 2000 ka garuar edhe me ngjyrat e AAK-së, andaj nuk mund ta luan rolin e themeluesit të LVV-së dhe nuk bënë të mohohet e kaluara asnjëherë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, të nderuar, jemi në dijeni se është mbledhja e fundit e këtij mandati të kësaj legjislature dhe unë isha mjaft tolerant me dhënien e fjalës, kohëzgjatjes së diskutimit dhe çështje tjera, krejt kjo me qëllimin më të mirë që askush të mos mbetet pa e thënë atë që ka për ta thënë qoftë edhe jashtë temës, mirëpo tani së fundmi filluan të përmenden Partitë politike dhe të bëhen akuza e kundër akuza, secili për secilin e dim ku ka qenë, ku ka shkuar, e ku është, andaj nuk mendoj që është mirë të hymë në atë pjesë sepse nuk është momenti tani ngase jemi në fushatë, unë nuk e mohoj asnjëherë ku ka qenë e ku jam dhe nuk e ndërroj asnjëherë përderisa merrna me politikë, këtu në këtë pozitë dhe këtë mandat asnjëherë nuk kam qenë politik, prandaj ta përfundojmë këtë debat dhe e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të prezantuar në fillim të kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 29 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës sa ishin prezent në sallë, me 18 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti "Furnizim me Pajisje për Blegtori", sipas materialit përkatës të prezantuar dhe shpërndarë në fillim të mbledhjes.

5. Të ndryshme

znj.Tringa Sfishta, theksoi, po shihet interesimi i pushtetit dhe si nuk po ju vie turp juve kandidatëve që jeni ë garë për ulëse edhe për një mandat në këtë Kuvend. E them këtë sepse qëndruan në sallë vetëm në pikën për projektbuxhetin që i'u interesoj kurse për hallet dhe nevojat e qytetarëve siç duket fare nuk po i'u intereson, përjashto vetëm 3 prej tyre që janë të interesuar dhe po qëndrojnë ë sallë, dhe tani po shfrytëzoj rastin të the atë që dola, po vazhdoj me pyetjet e mia në funksion të transparencës për qytetarët, drejtuar drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë.

A mund të bëhet e qartë se cilët specialistë janë angazhuar në punë në Ambulanten Specialistike, pra a mund të na prezantosh emrat se kush janë ata specialistë, ai i Kardiologjisë, Gjinekologjisë, Reumatologjisë, Endokrinologjisë, Mefrologjisë, Pulmoigjisë, Ortopedisë, Pediatriisë dhe Neurologjisë, po ashtu edhe të Urologjisë, Kirurgjisë Abdominale, Torakale dhe asaj Vaskulare.

Gjithashtu Hemodializa, a është e mundur që në Qendrën e Hemodiazlizës nuk ka gjenerator e që pacientët varen drejtpërdrejtë nga rryma elektrike, kush mban përgjegjësi për këtë rrezik për jetën e tyre, a e konsideroni normale që në Qendrën e Hemodiazlizës pajisjet të sillen me dorë, a ka staf të mjaftueshëm që secilit prej tyre t'i sille pajisja me dorë, këtë e them sepse sa jam në dijeni unë nëse nuk gaboje janë 15 pacientë që e marrin shërbimin e Hemodializës, prandaj nëse ka mundësi kërkoj përgjigje për këto pyetje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, të nderuar po e shihni që nuk kemi kuorum për të vazhduar tutje sepse nuk jemi të pranishëm gjysma e anëtarëve të Kuvendi ashtu siç kërkohet, andaj tani po e përfundojmë një mandat në këtë mënyrë e që nuk do të duhej.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, kur po i'u duhet kuorumi ti i nderuar Kryesues po i pret me nga 20 minuta, pastaj në fillim seanca hirrret në ora 10:00 dhe duhet të filloj në ora 10:00 dhe ne LDK po në atë kohë jemi të pranishëm gjithherë, kurse ti i nderuar z.Haki Rudari duhet të dalësh t'i mbledhësh anëtarët e LVV-së, ndërsa tani në pikën Të Ndryshme e potenconi se nuk ka kuorum a, kjo nuk i'u ka hije.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ju lutem të mos bëjmë shaka në një formë sepse nga asnjëra parti nuk janë prezent të gjithë, vetëm 8 të LDK-së i ke në sallë.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, i nderuar Kryesues, prezent në sallë nga radhët e LDK-së janë të gjithë ata që kanë qenë nga mëngjesi në fillim të kësaj mbledhje.

z.Valon Demolli, theksoi, fillimisht për temën që ka ardh Partia në pushtet, do të thotë si kaloj ajo temë përgjegjësisë qytetare këta po i ikin, e para e punës do të ishte mirë të ishte këtu ky “Shpiceri” Kryetari i Komunës në këtë karriken këtu ku është i thirrur, i cili tash më e ka tejkaluar nivelin, prej “hajni ka kaluar në super hajn”. E ku e ka prurë Komunën tonë, ftojme prokurorinë për secilën kontratë sepse për secilën kontratë ka elemente penale.

Edhe një thirrje e kam, shkoni thirreni Kryetarin e Komunës që ta bënë fotografinë e fundit në ulësen e Kryetarit të Komunës, ndërsa për ty Kryesues i Kuvendit është marre kjo që vazhdimisht po na e ndal fjalën.

znj.Edona Shabani, theksoi, i nderuar Kryesues edhe un deshta të them diçka për fund meqë është mbledhja e fundit e këtij mandati dhe nuk jam në listën zgjedhore, mirëpo ti nuk po lejon fjalën duke thënë se nuk ka kuorum sepse partia në pushtet që ishte sapo i kaloj pikat e tyre iku duke e lënë sallën, por si do qoftë mirë është sepse edhe nuk po dihet se ti Kryesues me kë je, PDK, a je me LVV, a me LDK-në, qysh po e mbyll seancën kështu.

Kryesuesi i Kuvendit, e konstatoi të mbyllur dhe përfunduar këtë seancë të Kuvendit për të cilën potencoi se sipas të gjitha gjasave është seanca e fundit e kësaj legjislature dhe nuk do të doja të mbyllet këtë mënyrë kështu, pa kuorum e me fyerje e konstatime të ndryshme mes vete, por si do qoftë ju falënderoj të gjithëve ju dëshiroj suksese në garë për asamble komunale.

konstaton të përfunduar këtë mbledhje

Mbledhja përfundoi në orën 12:35

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;

Enis Sheholli

Osman Bajrami

Nr.Prot.01-060/04-0062886/25

Podujevë,

29 shtator 2025

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha